

1 E mërkurë, 12 korrik 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare e Seancës, ju lutem thërrisni çështjen.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
8 kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar  
9 kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup  
10 Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
12 Sot do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 04746.

13 Vërej që z. Thaçi, z. Selimi z. Veseli dhe z. Krasniqi,  
14 të katër janë të pranishëm në sallën e gjyqit sot.

15 Përpara sesa të ftoj dëshmitarin në sallë, duhet të  
16 trajtojmë një çështje në lidhje me Dëshmitarin 04746.

17 Trupi Gjykses vëren se me 4 korrik 2023, ZPS-ja dha  
18 njoftim për synimin e vet për të kërkuar leje për të ndryshuar  
19 listën e vet të provave materiale. Për pasojë tani i kërkoj  
20 ZPS-së të thotë në qoftë se është e gatshme që të bëjë  
21 kërkesën gojarisht tani.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Dokumenti  
23 është në listën e dokumenteve të Prokurorisë dhe unë dëshiroj  
24 këtë dokument ta përdor gjatë ditës së sotme gjatë marrjes në  
25 pyetje të dëshmitarit.

1 Dokumenti është SITF0069190 në versionin në shqip.

2 Ndërkohë që në anglisht është SITF00069191.

3 Sikurse ju përmendët, i nderuar Gjykatës, ky është një  
4 dokument i cili aktualisht nuk është në listën e provave  
5 materiale të Prokurorisë, por ne kemi kërkuar shtimin e tij.  
6 Kemi dhënë njoftim për synimin tonë për të përdorur këtë  
7 dokument dhe këtë njoftim e kemi dhënë më 4 korrik. Dokumenti  
8 është një listë e firmosur nga komandanti Drni dhe është një  
9 dokument të cilin ky dëshmitar ka thënë që e ka parë më  
10 përpara dhe që e ka marrë në kohën kur ai është nxjerrë.

11 Është i rëndësishëm *prima facie* dhe ka rëndësi  
12 domethënëse për të justifikuar shtimin e tij. Dokumenti është  
13 i shkurtër, është i drejtpërdrejtë dhe lidhet me ngjarjet që  
14 janë njoftuar në kuadër të kësaj çështjeje gjyqësore dhe është  
15 nxjerrë në versionin e vetë origjinal që prej vitit 2021.  
16 Është i përkthyer dhe është nxjerrë për Mbrojtjen në nëntor të  
17 vitit 2022.

18 Për rrjedhojë, ne kërkojmë shtimin e këtij dokumenti në  
19 listën e provave materiale në mënyrë që të mund ta përdorim  
20 këtë dokument me dëshmitarin në sallë e gjyqit sot.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
22 çaktivizuar]

23 [Anëtarët e Trupit Gjyqësor këshillohen]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi  
25 Mettraux.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja është që pse nuk e  
2 keni shtuar në listën e provave materiale deri tani?  
3 Domethënë, me fjalë të tjera, çfarë argumenti ose çfarë  
4 arsytimi na jepni tani që do të na binde neve që ta  
5 ndryshonim listën e provave materiale në këtë fazë të procesit  
6 gjyqësor?

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, është  
8 çështje anashkalimi, kam përshtypjen, sepse kemi pasur shumë  
9 materiale. Sikur e thashë edhe më përpara, është një material  
10 i cili është rishikuar, është nxjerrë dhe është bërë i ditur  
11 që prej vitit 2021, është një dokument të cilin dëshmitari e  
12 ka identifikuar dhe më herët. E thashë edhe më përpara, se ky  
13 është një dokument i drejtpërdrejtë, është dokument i shkurtër  
14 dhe është një dokument i cili lidhet me çështjet që janë  
15 njoftuar dhe që nuk cenon palët.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, keni  
18 koment?

19 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kemi koment.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic?

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim, të nderuar  
22 Gjykatës.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] Kam një kundërshtim në kuptimin që  
25 justifikimi që u tha nga Prokurorja është i mjaftueshëm për

1 kërkesë për të ndryshuar listën e provave materiale në këtë  
2 fazë të procesit gjyqësor. Unë kam probleme sa i takon  
3 arsyetimit që dha Prokuroria, domethënë, që i ka kaluar pa u  
4 vërejtur dokumenti dhe pa i kërkuar për shtimin në listën e  
5 provave materiale, pasi kjo mund të jetë cenuese për  
6 Mbrojtjen.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju të tjerët?

8 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kemi  
9 kundërshtime. Megjithatë meqenëse u çova në këmbë më lejoni të  
10 shtoj se kemi një pjesëtar të ri në ekipin e Mbrojtjes tonë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
12 çaktivizuar]

13 Në çfarë pike gjatë procesit sot mendoni se do ta  
14 përdorni këtë dokument? A dëshironi që ne të marrim një vendim  
15 tani apo mund të presë puna deri në seancën e radhës?

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk parashikoj që ta përdorë këtë  
17 dokument gjatë seancës së parë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të marrim  
19 një vendim lidhur me këtë sapo të kemi mundësi që ta  
20 shqyrtojmë me njëri tjetrin.

21 Atëherë znj. Sekretare, mund ta sillni dëshmitarin në  
22 sallën e gjyqit.

23 [Dëshmitari vijon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
25 mund të uleni.

1 Mirëmëngjes, Dëshmitar.

2 DËSHMITARI: Po.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

4 Sot do të vazhdojmë me dëshminë tuaj. Ju kujtoj që ju lutem  
5 përgjigjuni pyetjeve qartë me fjali të shkurtra. Në qoftë se  
6 nuk e kuptoni një pyetje ju lutem kërkoni avokatit që ta  
7 sqarojë pyetjen ose ta formulojë atë ndryshe.

8 Gjithashtu, ju lutem thoni se cila është baza e njohurive  
9 e fakteve dhe e rrethanave mbështetur në të cilën do t'ju  
10 drejtohen pyetjet.

11 Ju kujtoj që jeni nën detyrim që të tregoni të vërtetën  
12 siç u deklarua prej jush në deklaratën solemne dje.

13 Gjithashtu mos harroni të flisni afër mikrofonit, prisni  
14 pesë sekonda përpara sesa t'i përgjigjeni një pyetjeje dhe  
15 flisni me ritëm të ngadaltë.

16 Në qoftë se keni të nevojshme të bëjmë pushime, lirisht  
17 na kërkoni dhe ne do të marrim masat përkatëse.

18 Do të vazhdojmë tani me marrjen në pyetje nga Prokuroria,  
19 do t'i jap fjalën znj. Lawson që të vazhdojë me pyetjet për  
20 ju.

21 DËSHMITARI: W04746 [Vijon]

22 Pyetje nga Znj. Lawson: [Vazhdim]

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

24 PY. Mirëmëngjes, z. Mustafa. Kur përfunduar dje pasdite po  
25 diskutonim për njësitin BIA. Ju pyeta në qoftë se njësitin BIA

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04746 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 6

1 i raportonte komandës së zonës ose Brigadës 153 dhe ju thatë  
2 që nuk ju kujtohet ekzaktësisht se kujt i raportonte njësit  
3 BIA. Dhe kjo për transkript është në faqen T111.

4 Dëshiroj t'ju tregoj një pjesë të një deklaratë të  
5 mëparshme dhe të shohim në qoftë se ju kujtohet diçka tjetër.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Për palët referenca është pjesa  
7 17, faqja 2.

8 PY. Juve në atë moment u pyetët, nëse njësit BIA ishte pjesë  
9 e një brigade apo jo, përgjigja që ju dhatë ishte:

10 "Ishte pjesë e Brigadës 153. Më vonë, ata u ndanë më vete  
11 dhe u bënë një njësit më vete. Ishte një njësit që ka vepruar  
12 kryesisht në Prishtinë edhe gjatë kohës së okupacionit".

13 Kështu që a është e saktë kjo? Fillimisht njësit BIA ka  
14 qenë pjesë e Brigadës 153 dhe pastaj është bërë njësit më  
15 vete, është ndarë, është e saktë kjo?

16 PË. Znj. Prokurore, njësia BIA dhe Brigada 153 është një  
17 shoqëri. Por, njësia BIA ka qenë e themelume para brigadës dhe  
18 unë besoj që kjo njësi ka ndihmu në formimin e Brigadës 153.

19 Është histori interesante. Mirëpo, është shoqëri e njëjtë  
20 mbi bazën e të cilës janë ndërtuar këto dy këto dy njësi. Ka  
21 kanë me ndikim Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës dhe ne  
22 kemi pasë kujdes me propozimet që venin nga LKÇK-ja sepse  
23 donim t'i mirëmbanim brenda Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

24 PY. Pra, ju nuk ju kujtohet që njësia BIA është ndarë  
25 ndonjëherë nga Brigada 153, këtë po thoni?

1 PË. Jo, më kujtohet. E di se kanë vepru ndaras, por nuk e di  
2 momentin kur janë nda. E di që njësia BIA ka qenë njësi e  
3 veçantë që ka mund t'i raportojë zonës operative të Llapit,  
4 gjegjësisht mua dhe shtabit tim.

5 PY. Në rregull. Faleminderit. Kam edhe një pyetje tjetër për  
6 të sqaruar diçka më tej lidhur me atë çfarë diskutuam dje. Ju  
7 pyeta se kush tjetër ishte në Likoc kur Kadri Kastrati u  
8 caktua në zonën e Llapit nga Shtabi i Përgjithshëm, ju na  
9 thatë se nuk ju kujtohet.

10 Dëshiroj t'ju tregoj një pjesë të shkurtër të deklaratave  
11 të mëparshme, një prej deklaratave të mëparshme që keni dhënë.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Për referencë kjo është pjesa 2,  
13 në faqen 24.

14 PY. Ju keni thënë:

15 "E njihja Hashim Thaçi sepse isha takuar me të një herë  
16 më përpara kur Kadri Kastrati, zëvendësi im u kyç në luftë. Ne  
17 e kemi parë njeri-tjetrin në Drenicë".

18 A është e saktë kjo?

19 PË. Po ka mund të jetë.

20 PY. A ka qenë Hashim Thaçi një ndër personat e pranishëm aty?

21 PË. Po, ka mundur me qenë. Ka mund me qenë.

22 PY. A ju kujtohet se kush tjetër ka qenë i pranishëm në atë  
23 rast?

24 PË. Likovci ka qenë qendër e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës  
25 dhe aty ka pasë shumë bashkëluftëtarë. Ka mund të jetë edhe

1 ndonjë njeri tjetër. Por e rëndësishme ka qenë që unë kam  
2 shkue, si objektiv e kam pasë, takimin me Kadri Kastratin dhe  
3 marrja në zonën time.

4 PY. Përmendët dje që dikush që njihej me emrin Ilir është  
5 përmendur në komunikimet me kodin 106. A mund të na e  
6 shpjegoni ju lutem se çfarë do të thotë ky kod? Ça kuptimi ka  
7 kod?

8 PË. Shifrat me të cilat kemi komunikuar me radiolidhje. Unë,  
9 për shembull, kam qenë numri 100.

10 PY. Këto kode komunikimi a ishin të miratuara nga Shtabi i  
11 Përgjithshëm?

12 PË. Jo, zonjë. Këto ishin të punuara nga stafi im dhe të  
13 miratuara nga unë.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të  
15 paraqitet një deklaratë e mëhershme.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
17 çaktivizuar].

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Për referencë, është Pjesa 4,  
19 faqet 8 deri në 9.

20 PY. Këtu ju përmendni informacion që është dhënë në librin e  
21 Skënder Zitajt [sipas përkthimit]. Ju thoni:

22 "Besoj që hollësitë e dhëna prej tij janë të sakta. Pra,  
23 njësisive ju jepeshin kode. Dardanisë i ishte dhënë gjithashtu  
24 një kod. Dhe besoj që këto kode na ishin dhënë ne nga Shtabi i  
25 Përgjithshëm".



1 A është i saktë ky informacion?

2 PË. Emërimi Dardania ka qenë i caktuar nga Shtabi i  
3 Përgjithshëm.

4 PY. Këtu ju flisni për kode, në numrin shumë. A mund të na  
5 thoni se çfarë kodesh ka miratuar Shtabi i Përgjithshëm?

6 PË. Unë mund të gabohem tani, por unë e di se emërimet si  
7 Dardania, Buna, Kështjella këto kanë qenë të miratuara nga  
8 Shtabi i Përgjithshëm, kurse numrat i kemi vendos vetë. Mirëpo  
9 edhe mund të gabohem tash pas aty. Sido që të jetë, është  
10 numri i njësive që i kemi vendosë në bazë që kemi komunikuar me  
11 radiolidhje. Me njësitet vartëse të miat kemi komunikuar vetëm  
12 ne në mes veti, jo të tjerët.

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshiroj t'ju tregoj një  
14 dokument. Për referencë ky dokument është SITF00242163. Dhe  
15 versioni në gjuhën angleze është me të njëjtin numër por ka në  
16 fund -ET. Ju lutem të paraqisni faqen 242167, që është faqja e  
17 pestë e dokumentit. Atëherë në qoftë se mund ta lëvizim pak  
18 faqen në gjuhën shqipe dhe do të fillojmë me pjesën në të  
19 djathtë të faqes.

20 PY. Mund të lexojmë këtu Dardania të nënvijëzuar. A mund të  
21 na shpjegoni çfarë domethënie kishte ky kod, për çfarë ishte  
22 caktuar ky kod?

23 PË. Ishin anëtarët e komandës së zonës me emrin Dardania dhe  
24 njësitet që ishin pranë shtabit.

25 PY. A i njihni të gjitha këto emrat që janë të listuar poshtë

1 emrit Dardania?

2 PË. Po.

3 PY. Ju përmendët që ju u ishte caktuar numri 100. Që e  
4 shikojmë të ngjitur me emrin tuaj. A mund të na shpjegoni se  
5 për çfarë shpjegohej ky kod, pra, kur përdorej kodi 100 ose  
6 numri 100 në çfarë rastesh?

7 PË. Kushdo që ka dashtë, ka mund të komunikojë me mue përmes  
8 radiolidhjes është drejtu me Dardania 100. Nuk është përmend  
9 emri Remi. Ashtu vlen edhe për numrat tjerë më poshtë.

10 PY. Shohim emrin Ilir 106. Dje na thatë që emrin personi e  
11 kishte Sabit.

12 PË. Po.

13 PY. Ju kujtohet?

14 PË. Po, po më kujtohet.

15 PY. A ju kujtohet mbiemri?

16 PË. S'po e kujtoj tani, por më kujtohet ndërkohë.

17 PY. Po Shpendi te 109, kush ishte?

18 PË. Muharrem Ismajli.

19 PY. Për çfarë ishte përgjegjës ky?

20 PË. Tash po më kujtohet se është caktuar për me u kujdes për  
21 njerëzit e komandës.

22 PY. Numri 111 nuk është këtu në listë. A të kujtohet se kujt  
23 i ishte caktuar ky kod?

24 PË. Nuk më kujtohet.

25 PY. Në rregull. Do t'i kthehem më pas kësaj. Shohim më

1 poshtë në listë kemi fjalën Kështjella. Kujt i referohet ky  
2 kod?

3 PË. Kështjella është Brigada 152.

4 PY. Profra është emri i parë poshtë kështjellës. Ky ishte  
5 komandanti i brigadës, kështu?

6 PË. Arif Muqolli, komandant i brigadës.

7 PY. Ky ishte komandant i brigadës, kështu?

8 A i njeh këto emrat që janë të renditura pas Profës?

9 PË. Jo, të gjithë.

10 PY. Do të shkojmë tek Ulpiana. Për çfarë është përdorur ky  
11 kod?

12 PË. Brigada 151.

13 PY. Ndërkohë dy emrat e parë janë Luta dhe Batusha që ishin  
14 komandant dhe zëvendëskomandant i kësaj brigade apo jo?

15 PË. Po.

16 PY. Nëse do shohim numrin 55, shohim emrin Syleviç. A ju  
17 kujtohet se kush ishte ky person?

18 PË. Mua më kujtohet një Syleviç që ka qenë i ndalum nga ne  
19 por unë nuk besoj që ai ka pasë numër, por mund të jetë një  
20 emër tjetër.

21 PY. Vazhdojmë në majtë, kodi Guri kujt i përket?

22 PË. Janë kode të mbrojtjes civile. Secili fshat ka pasë kodin  
23 e tij.

24 PY. Po Blini kujt i drejtohet?

25 PË. Më kujtohet që Blini ka qenë pjesëtar i Ushtrisë

1 Çlirimtare të Kosovës i vrrarë gjatë luftës. Mirëpo, Blini këtu  
2 mund të jetë edhe ndonjë fshat, mos ma merrni për fjale.

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Le të kalojmë në faqen tjetër të  
4 dokumentit.

5 PY. Në fillim të faqes lexojmë Lisi. A e dini se kujt i  
6 referohet Lisi, për këtë përdoret Lisi?

7 PË. Jo. Vetëm janë njerëz, ushtarët, eprorë të njësive të  
8 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nën komandën e zonës. Mesa po  
9 shoh këtu janë të fshatrave ku mbulonte Brigada 153, fshatrat  
10 e Prishtinës.

11 PY. Po policia ushtarake a kishte kod?

12 PË. Po.

13 PY. A ju kujtohet se çfarë kodi kishte?

14 PË. Jo, nuk më kujtohet. Ka mund të jetë ai 111, që thamë më  
15 përpara. Vetëm po them ka mund, nuk e di sigurt.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Përfunduar me këtë dokument mund  
17 ta heqim nga ekrani.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] Përpara sesa të hiqet dokumenti  
19 nga ekrani. Nuk kemi dëgjuar asnjë dëshmi lidhur me kohën,  
20 lidhur me këto kode. Nuk kemi asnjë informacion lidhur me  
21 datën e këtij dokumenti. Megjithatë e dimë që dëshmitari ka  
22 dhënë prova, dëshmi, për ZPS-në më përpara sa i takon kohës.  
23 Por thjesht doja të thosha që ky dokument duhet që të lidhet  
24 dhe me datat, pra, në çfarë date ose në çfarë kohe janë  
25 përcaktuar kodet.

1 Me çfarë kohe, periudhe kohore lidhen këto kode.

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po mund të eksplorojmë më tej  
3 mund të pyes më tej sa i takon kohës edhe kodeve.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

6 PY. Dëshmitar, a mund të na thoni ju lutem, afërsisht, se në  
7 çfarë date janë përdorur kodet që ne pamë së bashku në zonën  
8 operative të Llapit?

9 PË. Nuk më kujtohet. Duhet të jetë fundi i 1998, fillimi i  
10 1999. Po mund të ndodh që ka shumë kode që s'janë përdorë  
11 asnjëherë.

12 PY. A njihni dikënd me emrin Skënder Zitaj?

13 PË. Skënder?

14 PY. Zitaj.

15 PË. Jo.

16 PY. Mbase po e them gabim emrin. Zhitia mbase.

17 PË. Po.

18 PY. Nga e njihni këtë?

19 PË. Ka qenë ushtar dhe më vonë epror i Ushtrisë Çlirimtare të  
20 Kosovës.

21 PY. Në zonën e Llapit?

22 PË. Po.

23 PY. A ju ka intervistuar ai ju kur po përgatiste një libër  
24 për zonën operative të Llapit?

25 PË. Ka fol për librin. Intervistë nuk po më kujtohet, por ka

1 fol për librin që e ka shkru me mua.

2 PY. A e keni parë librin, a e njihni librin e tij që është  
3 botuar në vitin në vitin 2008 dhe që mban titullin "Zona  
4 operative e Llapit, Ushtria Çlirimtare e Kosovës"?

5 PË. Po, e njoh.

6 PY. A keni një kopje të këtij libri?

7 PË. Besoj po.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshiroj që të paraqitet në ekran  
9 një provë materiale. Është dokumenti SPOE00055678. Do shohim  
10 faqen 55707. Ndërkohë versioni i përkthyer në anglishte është  
11 SPOE00055705-ET i Rishikuar. Faleminderit. Mund ta kalojmë pak  
12 më poshtë faqen në gjuhën shqipe.

13 PY. Këtu e shikon që këtu po shkruhen shifrat thirrëse të  
14 përdorura në sistemin e komunikimit. Dhe përputhet me  
15 diskutimin që sapo patëm.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të kalojmë tani në faqen 55707,  
17 ju lutem, të kalojmë në fund të faqes.

18 PY. E shikoni që aty përmendeni ju si një burim informacioni  
19 kur ai po hartonte këtë dokument?

20 PË. Po.

21 PY. Thatë në disa raste që nuk ju kujtohen disa gjëra,  
22 prandaj t'i shohim tani. Kur po diskutonim dje për sektorët  
23 thatë fillimisht që Fatmir Humolli ishte përgjegjës për  
24 sektorin e moralit, pastaj thatë që e ngatërruat sektorët dhe  
25 dhatë një emër tjetër për këtë, Valon Murati.

1 Në faqen 707 --

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Një faqe më përpara ju lutem, në  
3 fund të faqes në shqip.

4 PY. Shohim këtu se në fakt Fatmir Humolli, thuhet këtu, që  
5 është përgjegjës për sistemin e ndërlidhjes, pra, emëruar me  
6 shifrën, ishte shef i këtij sektori për çështje morale-  
7 politike, kështu?

8 PË. E saktë është kjo evidencë këtu.

9 PY. Dhe në pjesë të tjera të librit, nuk do t'i paraqesë këtu  
10 sepse do të na duhet të ndryshojmë dokumentet, po përmendet në  
11 një poshtëshënim Valon Murati si anëtar i sektorit të  
12 informimit --

13 PË. Publik, ndoshta.

14 PY. -- publik, po.

15 PË. E sigurtë kjo.

16 PY. Po në atë faqe, shikohet pseudonimi Bali për Ahmet  
17 Hamitin. Ju kujtohet?

18 PË. Po.

19 PY. Hamit Haliti,

20 PË. Hamit Hamiti.

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Pra, në shqip të kalojmë në faqen  
22 SPOE00055849 dhe anglishten duhet ta ndryshojmë të shkojmë tek  
23 dokumenti SPOE0055799 dhe është ET e Rishikuar ky version.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Unë shoh vetëm një  
25 version 08 të Rishikuar.

1 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të përdorim këtë version.

2 Të kalojmë në faqen 5851 në të dy dokumentet, ju lutem.

3 PY. Aty shohim se thotë që policia ushtarake kishte kodin

4 Zjarri nga numri 500 e poshtë, kështu ka qenë?

5 PË. Tash po mendoj që duhet me qenë kështu, po s'po më

6 kujtohet. Si Zjarri është interesat emër për mua.

7 PY. Ju kujtohet se çfarë numër telefonit përdornit në atë

8 kohë?

9 PË. Jo, nuk më kujtohet numri i telefonit.

10 PY. Komunikimi ishte në nivel të mirë në zonën e Llapit?

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Me gjithë respekt, nuk është një

12 pyetje e saktë, e përcaktuar qartë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni

14 çaktivizuar].

15 Po fillojmë me atë pyetje dhe pastaj shohim, mund të

16 përpunohet gjatë rrugës.

17 Mund t'i përgjigjeni Dëshmitar, kësaj pyetjeje.

18 DËSHMITARI: Jo, nuk ka qenë komunikimi përmes telefonave

19 i mirë. Në atë kohë numrat e telefonave ka qenë të

20 kontrolluara nga Serbia. Kurse ne për nevoja të komandës kemi

21 pasë edhe telefon satelitor. Mirëpo, shpesh herë edhe ata kanë

22 qenë jofunksional dhe për arsyeja që të pagesave, mundësive me

23 bë pagesën paguheshin jashtë e kështu me radhë. Domethënë

24 komunikimi nuk ka qenë dhe i kënaqshëm nuk ka qenë.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04746 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 17

1 PY. Të diskutojmë pajisjet që përdornit. Çfarë pajisje  
2 komunikimi kishit?

3 PË. Po ka pasë radiolidhje, telefon dhe personalisht  
4 udhëtimi, takime sy më sy.

5 PY. Kishit pajisje komunikimi me këto radiolidhje që i mbanit  
6 në dorë, këtë keni parasysh?

7 PË. Po.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Prapë më vjen keq që ju ndërpres,  
9 po a mund të na përcaktohet data se kur janë përdorur këto?

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. Jepni  
11 datat kur, në ç'kohë janë përdorur këto.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

13 PY. Dëshmitar, a mund të na thoni përafërsisht se kur i  
14 siguruat këto pajisjet e radiove?

15 PË. Numër të vogël të tyre për zonë, për shembull, tre, katër  
16 copë kemi pasë që në fillim në qershor-korrik 1998.  
17 Gradualisht ka ardhë duke u shumë numri i tyre. Kanë sjellë  
18 njerëzit dhe është ardhë numri duke u rrit.

19 PY. Kishit ndonjë vend të caktuar ku i merrnit këto  
20 radiolidhje?

21 PË. E kujtoj që një numër i radiolidhjeve ka ardhë nga  
22 perëndimi.

23 PY. Këto radiolidhjet i kishin dhe brigadat dhe njësitet?

24 PË. Po, kanë qenë dhe njësitet. Mirëpo ka qenë problem, ne  
25 kemi qenë pa rrymë dhe vështirë ka pa me i akumuluar, me i

1 mbushë. Kemi pasë vështirësitë e tona teknike.

2 PY. Dhe ju thatë që kishit edhe një numër telefonash  
3 satelitor. Po ato nga i siguruat, nga i morët?

4 PË. Ato kanë ardhë nga jashtë, nga bashkatdhetarët tanë. Mua  
5 më kujtohet që dy prej tyre kam marrë nga shefi i zyrës  
6 politike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Demaçi.

7 PY. Afërsisht në ç'kohë i keni marrë këto?

8 PË. Mund të jetë pas shtatorit ofensivës kundër nesh që ishte  
9 zhvilluar.

10 PY. Ku i mbanit këto telefonat satelitorë?

11 PË. Telefoni që ka qenë i komandës, është mbajtur në komandë,  
12 aty ku kemi qëndruar, aty e kemi mbajtur telefonin.

13 PY. Kush kishte të drejtë t'i përdorte apo qasje në të?

14 PË. Kanë qenë komandantët e brigadave. Ata kanë mujt me leju  
15 edhe të tjerët, për hir të numrit të vogël se kushtonin  
16 shtrenjtë, është dashtë me kanë numri i kufizim i atyre që  
17 kanë pasë të drejtë ta përdorin.

18 PY. Pajisjet e komunikimit që kishit ju mundësonin të  
19 komunikoni me zonat e tjera dhe me Shtabin e Përgjithshëm?

20 PË. Ka pasë momente që kemi zanë lidhjet po kanë qenë shumë  
21 të vështira sepse ndërhyrja e forcave armike në to ka qenë e  
22 lehtë. Ne s'kemi mund ose s'kemi ditë të punojmë mirë me to  
23 edhe ka pasë probleme.

24 PY. Po Shtabit të Përgjithshëm i dhatë pajisje të tilla  
25 komunikimi?

1 PË. Po, më kujtohet kur kanë ardhë këto nga perëndimi, unë  
2 kam ofruar dy radiolidhje por nuk më kujtohet se kemi  
3 komunikue përmes tyne me Shtabin e Përgjithshëm.

4 PY. E keni fjalën me këto, konkretisht me këto pajisjet, me  
5 këtë thoni, e keni parasysh?

6 PË. Po, po.

7 PY. A do të ishte e saktë të thoshim që anëtarët e zonës  
8 operative të Llapit kishin kontakte të rregullta telefonike me  
9 Shtabin e Përgjithshëm?

10 PË. Mundet me thënë për vete se unë kam pasë kontakte,  
11 mundësi, sa herë që kam mund me i marrë në telefon jemi  
12 dëgjue. Por të rregullta nuk kisha mujt me thënë.

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua që t'i  
14 kthehem një deklaratës së mëparshme, ju lutem.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta bëni.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do të filloj me Pjesën 3, faqja  
17 5, për referencë

18 PY. Pyetja është:

19 "Ju thatë më duket se kishit kontakte të rregullta me  
20 telefonat?

21 "PË. Po.

22 "PY. Ishin kontakte të përditshme?

23 "PË. Jo.

24 "PY. Të themi në janar 1999 mbanit kontakt të përditshëm  
25 me Shtabin e Përgjithshëm?

1 "PË. Përpiqeshim t'i kontaktonim me telefon, por nuk do  
2 të thotë që flisnim çdo ditë".

3 Është e saktë kjo që keni thënë?

4 PË. Është e njëjta që thashë edhe tani, po më duket kjo.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Pjesa 4, faqja 7 deri në 8.

6 PY. Përgjigja juaj ishte.

7 "Këta ishin njerëzit që njihnin të gjithë komandantët e  
8 zonave dhe ishin anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm. Dhe  
9 kishin numrat e telefonit të Shtabit të Përgjithshëm dhe  
10 flisnim me ta. Lidhur me kontaktet e përhershme, konstante, që  
11 më pyetët, këto i bëm me telefon, por kontakti më i sigurtë  
12 ishte ai fizik, por që ishte dhe më i vështirë për ta  
13 siguruar".

14 A është e saktë kjo?

15 PË. Po.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dua tani të paraqesim në ekran  
17 një dokument, ju lutem. Është një libër i botuar nga Jakup  
18 Krasniqi në 2006. Referenca në shqip është U015-8743. Në  
19 anglisht është U015-8859. Të kalojmë tek faqja 8864, ju lutem.

20 PY. Dhe mund ta lexoj tani këtë pjesën. Bëhet fjalë për një  
21 vizitë në zonat e Llapit dhe Shalës në tetor 1998 dhe thuhet  
22 kjo që vijon:

23 "Shkuam në këto zona për të parë me sytë tonë në terren  
24 se cila ishte situata operative, situata mbas ofensivës së  
25 shtatorit 1998. Kishim marrë disa informata të përgjithshme

1 për situatën nga komunikimet e përditshme me telefona  
2 satelitor por donim të kishim informata më konkrete”.

3       Është e saktë? Pra, ishit në kontakte të rregullta me  
4 Shtabin e Përgjithshëm edhe në mos jo të përditshme, kështu?  
5 PË. Ne kemi pasë kontakte vazhdimisht, por “të rregullta”  
6 varet si e kuptoni. Ne jemi përpjekur të jemi në kontakt të  
7 përhershëm me Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të  
8 Kosovës.

9 PY. Me sa kuptoj nga këto që thatë, që komandant e zonës  
10 lejoheshin të kishin kontakte me anëtarë të Shtabit të  
11 Përgjithshëm, kështu ka qenë?

12 PË. Ju lutem edhe një herë?

13 PY. Pra, ishte e lejuar që komandat e zonës të kishin  
14 kontakte të drejtpërdrejtë me Shtabin e Përgjithshëm, kështu?

15 PË. S’kemi pasë ndonjë ndalesë. S’më kujtohet që kemi pasë  
16 ndalesë për askënd.

17 PY. Duke përfshirë dhe brigadat dhe njësitet dhe këto kishin?

18 PË. Unë nuk besoj që kanë pasë kontakte, se nuk kam pasë edhe  
19 numërorin e tyre, por nuk ka pasë ndalesë për askënd të  
20 komunikojë me Shtabin e Përgjithshëm apo kudo.

21 PY. Për shembull, një person që përgjigjej për logjistikën  
22 mund të kontaktonte drejtpërdrejt anëtarin e Shtabit të  
23 Përgjithshëm që përgjigjej për logjistikën, kështu?

24 PË. Kontaktet zyrtare, Prokurore, kanë qenë përmes meje. Unë  
25 isha personi që përfaqësoja zonën operative të Llapit pranë

1 Shtabit të Përgjithshëm. Nuk më është drejtuar ndonjëherë  
2 shefi i logjistikës apo ndonjë tjetër se ka komunikuar me  
3 sektorët e ndryshëm të Shtabit të Përgjithshëm.

4 PY. Pra, kur e keni fjalën për kontaktet zyrtare me sa  
5 kuptoj, e keni fjalën për kontaktet personale, fizike, për  
6 këtë?

7 PË. Personale, fizike dhe në komunikim, lidhur me  
8 mbarëvajtjen e punëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.  
9 Kontakte ka mujt të jetë raport zëvendësi im meqë kam pasë  
10 njohje me shefin e shtabit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës  
11 apo ndonjëherë kur kam caktu unë dikën nga personeli të më  
12 marrë lidhjen me ta, me Shtabin e Përgjithshëm apo ndonjë  
13 komandant zone tjetër.

14 PY. Faleminderit. Do të kalojmë tani tek një temë tjetër. Kur  
15 e morët përgjegjësinë si komandant i zonës së Llapit.

16 PË. Me rënien e komandantit Zahir Pajaziti unë marrë përsipër  
17 dhe organizoj trupat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në zonën  
18 time. Kurse miratimi nga Shtabi i Përgjithshëm për pozicionin  
19 tim ka ardhë në korrik ose gusht 1998, miratim formal.

20 PY. Pra, në 1997 e morët përgjegjësinë pra, komandën mbas  
21 vrasjes së Zahir Pajazitit?

22 PË. Po.

23 PY. A u mor ndonjë vendim konkret që ju ta merrni këtë  
24 përgjegjësi?

25 PË. Jo, nuk ka pasë ndonjë. Kam pasë komunikim me miqtë e mi

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04746 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 23

1 që i kam njoh, luftëtarët që kishim mbetur gjallë dhe e kemi  
2 pa të nevojshme se duhet të funksionojnë kemi fillue  
3 gradualisht jemi konsolidue dhe kemi marrë lidhjet me Shtabin  
4 e Përgjithshëm dhe me të tjerë që ishin të interesuar të  
5 vazhdonin luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

6 PY. Dua t'ju tregoj një pjesë nga libri "Lufta për Kosovën:  
7 Flet komandant Remi".

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Në shqip është SPOE00330195 dhe  
9 të kalojmë në faqen 330236. Anglishtja ka numër SPOE00053263,  
10 duhet të shkojmë në faqen 53289. Të kalojmë në fund të faqes  
11 në shqip, ju lutem.

12 PY. E shikoni aty që shpjegohet takimi që është mbajtur në  
13 Urën Ballofci?

14 PË. Po.

15 PY. Është e saktë kjo që thuhet këtu?

16 PË. Po këto ishin marrëveshjet qysh dhe që ju thashë dhe më  
17 herët. U merrnim vesh me shokët, njerëzit janë anëtarë të UÇK-  
18 së. Dhe mund të thirret, mund ju ta quani dhe vendim, po kjo  
19 ishte marrëveshja për të vazhduar punën për të ec tutje.

20 PY. Në këtë pjesë ju vetë e përshkruan si takim zyrtar ku  
21 është marrë një vendim, a nuk është kështu?

22 PË. Ne kemi pasë nevojë me i zyrtarizu këto takime këtu, po  
23 ishin takime të atyre njerëzve që mund të takoheshin, që  
24 kishim mund me u mbledhë dhe jemi marrë vesh, mund të quhen  
25 dhe takime zyrtare pse jo.

1 PY. Ju lutem, lexoni me zë se cilët ishin të pranishëm në  
2 këtë takim?

3 PË. Unë, Latif Gashi, Ilir Konushevci dhe Murat Ajeti.

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të kalojmë në faqen tjetër në  
5 anglisht, ju lutem.

6 PY. Morët vendim dhe për anëtarët e komandës së zonës,  
7 kështu?

8 PË. Jemi pajtue që të plotësohet stafi i zonës. Mirëpo, ju  
9 duhet ta dini se intervista publike janë ese, tregime për  
10 publicitet. Dhe ne dosido i kemi rritur takimet tona i kemi  
11 qujt zyrtare, i kemi qujt si -- po mund ta marrim edhe kështu  
12 si është në libër, s'më pengon.

13 PY. Në pjesën që sapo pamë, thuhet që ratë dakord, u pajtuat  
14 që të mbanit kontakte me Shtabin e Përgjithshëm. Kush ishin  
15 njerëzit që kontaktonit në atë kohë në Shtabin e Përgjithshëm?

16 PË. Ka qenë Adem Jashari, komandanti, legjendari i themi ne.

17 PY. Si e takuat për herë të parë Rexhep Selimin?

18 PË. E kam takuar bashkë me komandantin Adem Jashari. Një ditë  
19 para se me rënë, para se me u bë lufta në Prekaz ku kishte  
20 rënë komandanti bashkë me familjen Jashari.

21 PY. Pra, ju e përmendni se u takuat me Adem Jasharin në  
22 mbrëmjen e 4 marsit 1998, kështu?

23 PË. Po.

24 PY. Do t'ju bëj disa pyetje konkrete lidhur me këtë. Me kë u  
25 takuat atje?



1 PË. Në mbrëmje kam shkuar në shtëpinë e Adem Jasharit bashkë  
2 me një mikun tim që ishim me studime Shekif Faziun. Nga aty  
3 kemi vazhdu rrugën për në një fshat ku Rexhep Selimi, Muj  
4 Krasniqi, Sylejman Selimi, ka mund të jetë edhe ndonjë tjetër.  
5 Në vendin ku i vizitonim të plagosur më kanë marrë me vete,  
6 kemi pasë për të shkuar në një nga fshatrat e Drenicës për  
7 konsolidim të radhëve për me fol për Ushtrinë Çlirimtare të  
8 Kosovës dhe me anëtarë tjerë të Shtabit të Përgjithshëm.

9 PY. Aty ju ishit si përfaqësues i zonës operative të Llapit?

10 PË. Po.

11 PY. E përmendët dhe më herët këtë gjë dhe kam përshtypjen që  
12 përmendët korrikun ose gushtin e 1998, por a erdhi një moment  
13 kur ju u caktuat zyrtarisht si komandant i zonës operative të  
14 Llapit nga Shtabi i Përgjithshëm?

15 PË. Ju thashë është formalizue në 1998, në korrik ose gusht  
16 të 1998. Por unë e shpreha për udhëheqje, për detyrë, po e  
17 bëja deri atëherë.

18 PY. Kush ju caktoi juve në detyrë?

19 PË. Gjatë një vizite që ishte bërë nga shefi i shtabit me  
20 zëvendësin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Me sa kujtoj unë  
21 ka ndodhë që më është miratue vendimi për të vazhdue punën  
22 zyrtarisht si komandant i zonës.

23 PY. Këtu ju përmendni Jakup Krasniqi dhe Bislime Zyrabin, a  
24 është e saktë kjo? E keni fjalën për këta dy?

25 PË. Po.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04746 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 26

1 PY. Si është bërë caktimi juaj në këtë pozicion, në këtë  
2 post, a ka pasë ndonjë dokumentacion, ndonjë letër të firmosur  
3 të shkruar?

4 PË. Znj. Prokurore, unë kam qenë duke e bërë detyrën. Atëherë  
5 për hir të nevojës që me qenë oportun me Shtabin e  
6 Përgjithshëm me faktorizue si Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës  
7 është miratue nga Shtabi i Përgjithshëm se unë jam ai që isha  
8 deri atëherë.

9 PY. Këtë gjë këta të Shtabit të Përgjithshëm e bënë përmes  
10 një dokumenti të shkruar?

11 PË. Me siguri ka qenë i shkruar.

12 PY. Ju thatë që kjo u krye në kuadrin e një vizite në zonën  
13 operative të Llapit, domethënë, që bëtë një vizitë në zonën  
14 operative të Llapit, është e saktë kjo?

15 PË. Unë isha komandant i zonës së Llapit. Ata kanë ardhur në  
16 vizitë nga Shtabi i Përgjithshëm.

17 PY. Po anëtarë të tjetër të Shtabit të Përgjithshëm në atë  
18 rast a erdhën në zonën operative të Llapit, përveç Jakup  
19 Krasniqit dhe Bislime Zyrapit, kishte të tjerë pra?

20 PË. Unë e di që ka pasë përfolje dhe janë përfol dhe emra të  
21 tjerë, por mua nuk më kujtohen me saktësi. Edhe nëse kanë qenë  
22 nuk kanë qenë me detyrë për zonën operative të Llapit për me  
23 pa organizimin tonë.

24 PY. Anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm ju caktuan vetëm juve  
25 në atë vizitë apo konfirmuan dhe caktime të tjera në detyrë të

1 personave të tjerë brenda zonës operative të Llapit?

2 PË. Nuk mbaj mend, po mund të kenë pasë edhe konfirmime të  
3 tjera.

4 PY. Çfarë tjetër u diskutua gjatë takimit që organizuat me  
5 përfaqësuesit e Shtabit të Përgjithshëm?

6 PË. Interesimi që të organizoheshim sa më mirë, të  
7 komunikoni dhe të përgatiteshim për sfida të reja të luftës,  
8 stërvitja e ushtarëve, angazhimi, rekrutimi këto ishin. Me  
9 ardhjen e eprorëve nga jashtë që udhëhiqeshin nga shefi i  
10 shtabit, ne po synonim tani të organizoheshim më mirë kështu,  
11 të strukturoheshim më mirë.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dua që të kërkoj që të paraqitet  
13 në ekran përsëri librin e Zhitisë. Është dokument SPOE00055678  
14 për referencë. Faqen 55899. Ndërkohë që versioni në gjuhën  
15 angleze është dokumenti SPOE0055799. Do të paraqesim faqen  
16 55819 të versionit në anglisht.

17 PY. Mund të shohim këtu që ai ka përshkruar këtë vizitë, pra,  
18 vizitë e gushtit të 1998, është e saktë kjo?

19 PË. Nuk mundem të konfirmoj me siguri, po s'kam arsye të  
20 dyshoj në shkrime të z. Skënderi. Është vështirë për mu, me  
21 komentu librat publicistik të të tjerëve, znj. Prokurore.

22 PY. Ai përmend edhe anëtarë të tjerë të delegacionit, duke  
23 përfshirë këtu dhe Hashim Thaçin dhe Rexhep Selimin, është e  
24 saktë kjo?

25 PË. Mua më kujtohet që kam pasë punë me këta të dy, po nuk mu

1 prish punë edhe nëse është kështu. Unë nuk më kujtohet. Unë  
2 nuk kam pasë, nuk më kujtohet ndonjë debat apo punë për  
3 organizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës gjatë kësaj kohe  
4 nga Hashim Thaçi dhe Rexhep Selimi. Nuk ka qenë e rëndësishme  
5 për me e mbajt unë mend edhe nëse jam takue nuk ka qenë e  
6 rëndësishme në atë kohë.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër. Edhe  
8 një faqe më poshtë.

9 PY. Këtu thuhet që delegacioni u nda i kënaqur me të  
10 arriturat e zonës dhe largohet duke inkurajuar, duke ju  
11 inkurajuar juve se keni mbështetjen e të gjitha segmenteve,  
12 është e saktë kjo?

13 PË. Po, po ma merr mendja që kështu është dashtë me thanë për  
14 me inkuraju sepse ajo ishte koha kur po synonin me u rrit, me  
15 ec para. Po saktë nuk më kujtohet mua detaisht tash çfarë kanë  
16 thënë për këto lëvdata që na i kanë bë.

17 PY. Çfarë detyrash kishit ju si komandant i zonës?

18 PË. Organizimin e të gjitha njësiteve pranë zonës operative  
19 të Llapit dhe të gjithë punën që dilte për ndërtimin e  
20 strukturimin e zonës.

21 PY. A përfshihej këtu edhe respektimi i strategjisë së luftës  
22 së UÇK-së siç ishte përcaktuar nga Shtabi i Përgjithshëm?

23 PË. Për kohën për të cilën po flasim, këto janë terminologji  
24 që kanë fillu me u përfol por nuk ka pasë ende ndonjë  
25 strategji të shkruar. Strategji e përgjithshme ka qenë largimi

1 forcave armike nga vendi. Kjo ka qenë. Ne po konsolidoheshim  
2 dhe dalëngadalë po i përpilonim strategjitë edhe dokumente  
3 tjera.

4 PY. A përfshihej këtu edhe kontakti i vazhdueshëm me Shtabin  
5 e Përgjithshëm?

6 PË. Po, unë isha i obliguar. Kisha marrë obligim që të  
7 kontaktojë me Shtabin e Përgjithshëm edhe në takimet që ishin  
8 të mundshme të marrë pjesë.

9 PY. A keni pasur ndonjë takim me komandën e zonës së Llapit?

10 PË. Takim me zonën së Llapit unë po mendon?

11 PË. Po. Juve a keni organizuar takime të brendshme të  
12 komandës së zonës së Llapit?

13 PË. Po, gjithsesi.

14 PY. Besoj që ka pasur raste kur një ose më shumë pjesëtarë  
15 mbase nuk e kanë pasur të mundur që të merrnin pjesë në një  
16 takim të caktuar, a është e saktë kjo?

17 PË. Sigurisht.

18 PY. Nëse dikush nuk ishte i pranishëm në mbledhje a  
19 informohej më pas se çfarë kishte ndodhur gjatë mbledhjes?

20 PË. Po.

21 PY. Si komandant i zonës a shkonit ju për të vizituar  
22 njësitet e ndryshme të zonës së Llapit?

23 PË. Po, sa herë që kam pasë mundësi, kam dalë në vizita.

24 PY. Po komanda e zonës së Llapit a merrte raporte nga  
25 njësitet dhe brigada të ndryshme?

1 PË. Jemi përpitur të organizohemi sa më mirë dhe aq sa kemi  
2 mund kemi bë. Tash detajet nuk më kujtohen, po ne i kemi  
3 parashtrur detyrat për njësi që të raportojnë, që referojnë  
4 punën e tyre pranë shtabit të zonës.

5 PY. Sa shpesh ndodhte që të kishit kontakte me komandantët e  
6 brigadës në zonën e Llapit?

7 PË. Varësisht nga situata, për shembull, këto kohë kur po  
8 flasim para ofensivës së shtatorit, unë kam qëndru bashkë me  
9 dy prej komandantëve, gati kanë qenë ditore takimet. Ma vonë,  
10 mundësitë kanë qenë më të dobta për t'u takuar shpesh, për  
11 shembull, sidomos në Brigadën 153 nuk mund me u pa, me u taku  
12 shpesh.

13 PY. Kjo ishte pyetja ime e radhës në fakt. Në qoftë se  
14 komandantët e Brigadës 151 dhe 152 kanë qenë në kontakt ose në  
15 takime të përditshme me juve në atë kohë?

16 PË. Të përditshme nuk kisha me thënë, por kanë qenë të  
17 shpeshta.

18 PY. Po, pothuajse të përditshme, kështu sikur thatë apo jo?

19 PË. Mundet me thanë edhe ashtu.

20 PY. Ushtarët në zonë tuaj a janë trajnuar, kanë marrë ndonjë  
21 trajnim, stërvitje?

22 PË. Po. Jemi përpjekë që të gjithë të marrin trajnim por ka  
23 ardhë koha shpejt jemi përfshi në luftë dhe shumë nga ata nuk  
24 qenë të trajnuar. Kanë shku drejtpërdrejt në luftë.

25 PY. Për ata që janë trajnuar a përfshinte trajnimi dhe

1 informacion që lidhet me zinxhirin e komandimit?

2 PË. Po, besoj që po. Tani nuk më kujtohet. Besoj që po.

3 PY. Kur keni qenë komandant i zonës a keni nxjerrë urdhra?

4 PË. Po.

5 PY. A mund të na jepni një shembull sa për ilustrim?

6 PË. Ata kanë qenë rrallë me shkrim, po edhe me po kanë qenë

7 me gojë për dislokimin e trupave, për angazhimet në vijë

8 mbrojtëse, për hapjen e rrugëve të ndryshme që ishin të

9 nevojshme për ne. Detyra ushtarake në përgjithësi.

10 PY. Si komandant zone a kishe kompetencë që të inspektoje

11 ndonjë njësit ose ambiente të zonës operative të Llapit?

12 PË. Unë isha vetë komandanti, Prokurore, kisha mundësi të

13 bëja këtë.

14 PY. Sa i takon hierarkisë, anëtarët e komandës së zonës janë

15 në hierarki më lart sesa anëtarët e UÇK-së në zonë?

16 PË. Ata janë anëtarë të shtabit. Kanë qenë të privilegjuar në

17 atë kohë nuk ka pasë gradime, po normalisht që kanë qenë në

18 hierarki më lart.

19 PY. A ka pasur rregullore për disiplinën në UÇK?

20 PË. Ka pasë disa lloje të rregulloreve. Ka pasë edhe -- kemi

21 shfrytëzu burimet e literaturave të vjetra nga Shqipëria

22 gjithashtu edhe nga ushtri të tjera të regjionit. Eprorët e mi

23 kanë bërë edhe vetë rregullore. Në zonën time, ka pasë shumë

24 eprorë që kishin përfunduar akademinë në ushtrinë e ish-

25 Jugosllavisë dhe ata njiheshin me këto rregullore dhe ata i

1 bënim.

2 Na ka ndihmu në rregullore edhe zyra politike e Ushtrisë  
3 Çlirimtare të Kosovës nga Adem Demaçi. Ai ka pasë një  
4 grumbullim të këshilltarëve, ku këshilltarë të tij kishte dhe  
5 gjeneralë që ishin në armatën e ish-Jugosllavisë ma herët.  
6 PY. Pra, konkretisht, a kishte rregullore për disiplinën në  
7 UÇK?

8 PË. Po.

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshiroj të paraqes një dokument.  
10 Për referencë është dokumenti P00165. Versioni në anglisht ka  
11 të njëjtin numër identifikimi dhe përfundon me ET pas numrit  
12 PY. A e njihni këtë dokument?

13 PË. Kështu si është, nuk e njoh.

14 PY. Nëse do t'ju tregoja më shumë faqe të këtij dokumenti a  
15 do t'ju ndihmonte mbase?

16 PË. Ndoshta.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] A mund të kalojmë ngadalë dy-tre  
18 faqet e para, ju lutem. Kalojmë dhe te faqja tjetër.

19 DËSHMITARI: Jo, znj. Prokurore. Ka mund të jetë në dorë  
20 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të ushtarëve të mi, por  
21 mua nuk më duket i njohur.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nëse më  
23 lejoni dua që përmend një deklaratë të mëhershme të  
24 dëshmitarit.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.



1 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Për palët referenca është Pjesa  
2 2, faqja 6.

3 PY. Juve ju bëhet kjo pyetje:

4 "PY. Z. Mustafa, a jeni në dijeni të rregullores për  
5 disiplinën të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së? Dhe do t'ju  
6 jap një kopje të kësaj rregulloreje".

7 Përgjigja që jepni është:

8 "PË. Po, më kujtohet kjo rregullore".

9 Pastaj vazhdohet më tej me pyetjen:

10 "PY. A është e saktë që kjo është rregullorja e  
11 disiplinës brenda Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?"

12 Përgjigja juaj është:

13 "PË. Po, me sa më kujtohet mua. Po".

14 A ju kujton kjo ndonjë gjë?

15 PË. Nëse e kam thënë, s'ka arsye me i ik këtij dokumenti, por  
16 tash s'mu kujtu dhe unë po pajtoj me atë që kam thënë. E di që  
17 ka pasë shumë rregullore në këtë kohë. Shumë libra, shumë të  
18 shkruara dhe kjo mund të jetë një nga ato. Edhe jam i sigurtë  
19 që edhe nga Shtabi i Përgjithshëm kanë ardhë rregullore të  
20 ndryshme për disiplinë.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] A të ngre një çështje që ka të  
22 bëjë me formën sesi po bëhen pyetjet, sepse në vend që t'i  
23 tregohet transkripti i intervistave dëshmitarit thjesht po  
24 lexohen pjesë të caktuara të intervistës.

25 Por unë vetë, për shembull, ndërkohë që po mundohesha që

1 të ndiqja atë çfarë po thoshte Prokurorja e kisha të vështirë  
2 nuk mund të gjeja dot ndonjë referencë apo ndonjë informacion  
3 që lidhej me transkriptin e ZPS-së. Kështu që është e  
4 rëndësishme që të thuhet se ku, për shembull, në transkript  
5 përmendet dokumenti që u tregua dëshmitarit në mënyrë të tillë  
6 që të sigurohemi që bëhet fjalë për të njëjtin dokument.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Në rregull. Do japim informacion  
8 lidhur me këtë.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Më mirë sesa të na jepni shpjegim  
10 është e rëndësishme që të ndjekim të njëjtën linjë që kemi  
11 ndjekur gjithmonë sepse në qoftë se i thoni dëshmitarit se ky  
12 është dokumenti për të cilin po flasim, pra, do ishte mirë që  
13 të sqarohej.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, është e  
15 rëndësishme që të sqarohet në qoftë se bëhet fjalë për të  
16 njëjtin dokument apo jo.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dhe jo vetëm kaq, po duhet që të  
18 i bëhet pyetja përpara sesa të japë përgjigjen dhe të shikojë  
19 dokumentin dëshmitari përpara sesa të japë përgjigjen.

20 Pra, në qoftë se dëshmitarit i thuhet që ke dhënë një  
21 përgjigje për një dokument, i cili është i ndryshëm nga  
22 dokumenti që sapo pa, atëherë i takon që e gjithë linja e  
23 pyetjeve është çorientuese për dëshmitarin, sepse në të  
24 kundërtën në qoftë se nuk tregohet dokumenti si fillim, i  
25 takon që pyetja nuk ka kuptim.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk duket  
2 sikur është çorientuar dëshmitari. Dëshmitari dha përgjigjen  
3 më të mirë që mundej.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] Megjithatë për barazinë e armëve,  
5 a mund t'i kërkoj Trupit Gjykues që e njëjta praktikë do të  
6 duhet të përdoret nga Prokuroria ashtu siç është përdorur edhe  
7 me herët e tjera me dëshmitarët e tjerë nga Prokuroria. Pra,  
8 që të transmetohet, të paraqitet pjesa e intervistës në  
9 versionin në anglisht dhe në versionin në shqip në mënyrë të  
10 tillë që palët të mund të shohin dokumentin që përmend  
11 Prokurorja. Dhe ne, vazhdimisht, pra, na kërkohet kur bëjmë  
12 pyetjet tona që të paraqesim dokumentet në ekran për t'i parë.  
13 Këtë gjë po kërkoj dhe nga Prokuroria. Është çështje  
14 procedure.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,  
16 mos më ndërprit. Po mundohemi që të jemi të drejtë me të  
17 gjithë. Është një çështje me vend dhe Prokurorja do të tregojë  
18 dokumentet në qoftë se i mendon të rëndësishme. Ndërkohë në  
19 qoftë se keni gjëra për të sqaruar mund t'i sqaroni kur të  
20 bëni pyetjet tuaja. Dhe e përfundojmë, e mbyllim këtu këtë  
21 diskutim.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Gjykatës, i kemi mbaruar pyetjet  
23 lidhur me këtë dokument. Dhe do japim sqarimet e nevojshme.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, po mendoja në  
25 qoftë se të ngrihesha apo jo. Megjithatë është e rëndësishme

1 që ZPS-ja të na thotë se çfarë dokumentesh do nxjerrë sa më  
2 shpejt të jetë e mundur në mënyrë të tillë që ne të  
3 përgatitemi për pjesën tonë të pyetjeve pastaj.

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do t'i keni informacionet, do t'i  
5 keni dokumentet përpara sesa të filloni me marrjen në pyetje  
6 të dëshmitarit. Mendoj që do t'i keni ato përpara pushimit të  
7 drekës.

8 PY. A ju kujtohet ndonjë rast kur ndonjë prej vartësve tuaj  
9 nuk ka respektuar ose ka shkelur një urdhër të disiplinës, të  
10 rregullores së disiplinës?

11 PË. Ushtarët ndoshta?

12 PY. Po, një nga vartësit tuaj, ndonjë nga ushtarët.

13 PË. Po, kemi pasë dy-tre raste që kanë shkelë rregullat. Kanë  
14 prishë ambientin e luftës, ambientin ushtarak.

15 PY. Në çfarë mënyre, si e kanë bërë pra?

16 PË. E shtëna me armë në një vend ku ishte e ndaluar. E di që  
17 ka ndodhë. Kacafytje në mes ushtarëve. Këso shkeljes  
18 disiplinore dhe të tjera kemi pasë, që unë po i mbaj mend, po  
19 besoj që komandantët e brigadave kanë hasë në to më shpesh.

20 PY. Dhe çfarë lloj discipline në këtë rast ndërmerrej, pra,  
21 mase disiplinore?

22 PË. Kanë qenë masa të ndryshme dhe kërcënim se do të  
23 demobilizohen. Por s'kemi rast të demobilizim. Ndalim për të  
24 shkuar në shtëpi. Deri te izolimi i përkohshëm dhe çarmatosja  
25 e ushtarit, marrja me punë fizike, këto diçka kanë qenë.

1 PY. Kur i izoloni e keni fjalën që i ndaloni?

2 PË. Po.

3 PY. Pra, në zonën e Llapit kishte njerëz që janë ndaluar nga  
4 UÇK-ja?

5 PË. Po, znj. Prokurore. Kemi përfunduar një proces gjyqësor  
6 për këtë dhe mund ta merrni. Ka qenë proces gjyqësor i  
7 udhëhequr kundër nesh.

8 PY. E keni fjalën për procesin penal ku dhe ju keni qenë i  
9 akuzuar, këtë keni parasysh?

10 PË. Po.

11 PY. Çfarë prejardhje etnike kishin njerëzit e ndaluar?

12 PË. Kanë qenë njerëz që kanë rënë ndesh me rregullat e luftës  
13 dhe me ambientin e luftës. Nuk ka qenë interesi i joni të  
14 ndiqet nacionaliteti apo kushdo që shkelte këto rregulla,  
15 ishte kundër luftës. Meqë po pyetni ka mund të ketë serb,  
16 shqiptarë. Nuk jam i sigurtë për të tjerë. Por qytetarë të  
17 vendit tonë.

18 PY. Kur thoni kundërshtonin rregullat e luftës, çfarë keni  
19 parasysh?

20 PË. Ishin kundër misionit të lirisë ose prishnin ambientin e  
21 luftës, ambientin ku ne po qëndronim.

22 PY. Pra, ishin njerëz që e kundërshtonin misionin e UÇK-së?

23 PË. Ka pasë dhe të tilla edhe pse ishin më pak.

24 PY. Afërsisht sa njerëz janë trajtuar në këtë mënyrë në zonën  
25 e Llapit?

1 PË. Unë nuk e them vetëm për njerëz që ishin kundër misionit  
2 të lirisë, por në përgjithësi, duke përfshirë edhe ushtarët e  
3 mi, nuk kalon numri treshifror.

4 PY. Treshifror, për shembull, e keni fjalën 100 veta?

5 PË. Po, nuk kalon.

6 PY. Dhe këta ishin njerëz për të cilët u është gjykuar  
7 atëherë se ndalimi ishte një masë e domosdoshme?

8 PË. Po.

9 PY. Në çfarë vendesh në zonën e Llapit, me sa dini ju, janë  
10 ndaluar njerëzit nga UÇK-ja?

11 PË. Znj. Prokurore, po deshe tani mund të përpiqem t'i njoh.  
12 Po janë në një proces dhe për të gjitha ka evidencë.

13 PY. E kuptoj, por do ta vlerësoja nëse do të më jepnit një  
14 përgjigje.

15 PË. Aty ku ka qenë njësia, brigada tek ne 151, 152 dhe  
16 komanda e zonës, a ty ka mund të ketë një shtëpi ndalimi. Unë  
17 po i përmend që ka pasë në Bradash, Llapshticë, Buricë dhe  
18 krejt në fund, me sa di unë, në Potok dhe Majac.

19 PY. Po në Bajgorë janë mbajtur të ndaluar njerëz?

20 PË. Po, ka qenë edhe Bajgora.

21 PY. Po ka qenë një shtëpi ndalimi që të themi që ishte  
22 kryesorja midis këtyre që përmendët?

23 PË. Po, ishte në Llapashticë.

24 PY. Ka qenë gjithmonë e vendosur në Llapashticë apo është  
25 zhvendosur?

1 PË. Varësisht prej rrezikut ka mund të lëvizë.

2 PY. Dhe ku ka lëvizur?

3 PË. Ku ka qenë më sigurtë. Tash nuk më kujtohen detajet, nuk  
4 i di. Policia ka qenë, personeli ka qenë i obligum të kujdeset  
5 për ta dhe t'i strehojë në vende më të sigurta, si vetë  
6 ushtarët tanë.

7 PY. Kush i shoqëronte personat e ndaluar gjatë kohës që i  
8 lëviznit?

9 PË. Ka qenë personeli që është marrë me këtë çështje.

10 PY. Kush ishte ky personeli i caktuar për t'u marrë me këtë  
11 çështje?

12 PË. Policia e zonës.

13 PY. Do t'i marrim një nga një disa prej këtyre vendeve që  
14 sapo përmendët. Bajgora është ai fshati që caktuat dje në  
15 hartë me numrin 2?

16 PË. Po.

17 PY. Gjatë cilës kohë ka qenë shtabi i Llapit në Bajgorë?

18 PË. Ka mund të jetë korrik, gusht dhe pjesa e parë e  
19 shtatorit.

20 PY. Përse lëvizi në shtator?

21 PË. Pas ofensivës së madhe të armikut në 15 shtator, ne kemi  
22 lëvizë. Ishte lëvizje taktike e Ushtrisë Çlirimtare të  
23 Kosovës.

24 PY. Ku në ç'vend në Bajgorë ishte vendosur shtabi?

25 PË. Nuk e di a mundem me i thënë shtab se kemi fjetur të

1 shkepun nëpër shtëpitë e fshatarëve, mirëpo në shkollën e

2 Bajgorës kanë qenë rekrutët ku kanë fjet.

3 PY. Gjatë, përafërsisht, për sa kohë ose në ç'periudhë kohore  
4 janë mbajtur të ndaluar në Bajgorë njerëzit?

5 PË. Ka pasë që është mbajtur më gjatë. Po të tjerët kanë mujt  
6 me kanë dy orë, ka mujt me kanë me ditë dhe me javë.

7 PY. Ju folët për kohëzgjatjen që janë mbajtur të ndaluar  
8 kështu? Kishit parasysh kohën gjatë të cilës janë mbajtur të  
9 ndaluar?

10 PË. Po.

11 PY. Po unë po them në ç'periudhë kohore ka operuar, ka  
12 vepruar, kjo qendra apo shtëpia e ndalimit në Bajgorë?

13 PË. Mund më zëni për fjale por ka qenë korriku, gushti. Nuk  
14 jam i sigurtë për datat.

15 PY. Dhe njerëzit vazhduan të mbaheshin aty derisa lëvizti  
16 shtabi në mesin e shtatorit?

17 PË. Ka mund të jenë një ose dy. Të tjerët janë liruar. Ashtu  
18 ka qenë.

19 PY. Ku në Bajgorë, në cilin vend në Bajgorë mbaheshin të  
20 ndaluarit?

21 PË. Ka qenë një shtëpi me tre-katër dhoma sikur shtëpitë e  
22 tjera.

23 Znj. Prokurore, kjo është udhëheq në gjyq dhe ka vendime  
24 për këtë çështje dhe janë të gjitha evidencat. Po flasim për  
25 vendim që kryer në të gjitha shkallët në Kosovë nga UNMIK-u



1 dhe EULEX-i.

2 PY. Kur ju desh të lëvizte mbas 15 shtatorit, fillimisht  
3 përpara se ju të shkonit në Llapashticë, ku lëvizi shtabi?

4 PË. Në fshatrat Majac. Majac, Lupq. Janë afër.

5 PY. Dhe në tetor ju dhatë urdhër që njësitet të kalonin të  
6 shkonin në Llapashticë, kështu?

7 PË. Po.

8 PY. Ju thatë që të ndaluarit mbaheshin dhe në Llapashticë.

9 Kur filloi të operonte kjo qendra apo shtëpia e ndalimit aty?

10 PË. Me siguri pasi që është vendos shtabi i zonës.

11 PY. Pra, i bie të ketë qenë tetori i 1998, kështu?

12 PË. Nuk po lidhem me datë, po e di që është shpejt ka ndodhë  
13 menjëherë.

14 PY. Pra, qendrat e ndalimit janë ngritur menjëherë, këto po  
15 thoni?

16 PË. Po.

17 PY. Përveç komandës së zonës, në Llapashticë, kishte dhe  
18 njësitate të tjera?

19 PË. Po, ishin njësitet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

20 PY. Cilat njësitate ishin aty?

21 PË. Brigadat 151, 152 kishin dërguar njësitate për mbrojtjen e  
22 shtabit.

23 PY. Po policia ushtarake që i bashkëngjitej zonës dhe ata aty  
24 e kishin qendrën?

25 PË. Po. Bashkë, afër nesh.

1 PY. Përafërsisht sa larg ishin nga ndërtesa e shtabit?

2 PË. Nuk më kujtohet, po nuk ka qenë më shumë se 300, 500  
3 metra.

4 PY. Po të thoja 200 metra apo më pak, e kam të drejtë?

5 PË. Pajtohem nëse është.

6 PY. Nazif Mehmeti dhe njësitit i tij aty e kishin qendrën?

7 PË. Po.

8 PY. Po objekti i ndalimit në Llapashticë ku ndodhej?

9 PË. Aty. Aty pranë.

10 PY. Kur thoni "aty" e keni fjalën tek baza e policisë  
11 ushtarake?

12 PË. Po.

13 PY. Ju keni vajtur ndonjëherë në këtë ndërtesën e ndalimit?

14 PË. Aty ka qenë kuzhina edhe për pjesëtarët e komandës së  
15 zonës, unë kam udhëtuar shpesh deri aty. Ka mund të udhëtoj.  
16 S'më kujtohet sa herë, po e di se kam qenë.

17 PY. E keni fjalën tek kjo kuzhina që ishte te ndërtesa e  
18 policisë ushtarake?

19 PË. Po në atë kuzhinë kam shku edhe jam ushqy edhe vetë.

20 PY. Ju ka qëlluar t'i shihnit këta të ndaluarit ndonjëherë?

21 PË. Ka pasë rast që mu kanë. Më kujtohet që kemi drekuar  
22 bashkë me ta, jo në një tavolinë por brenda dhomës, brenda  
23 kuzhinës.

24 PY. A erdhi një kohë që këta të ndaluarit u lëvizën nga  
25 Llapashtica?

1 PË. Po.

2 PY. Kur ka ndodhur?

3 PË. Për të gjitha ka evidencë, po mua nuk më kujtohen tani,  
4 znj. Prokurore. Pajtohem me evidencat që janë publike.

5 PY. Pra, nëse unë duke u bazuar në deklaratën tuaj të  
6 mëparshme, a ka qenë 24 marsi 1999, do të dukej e saktë?

7 PË. Po, z. Kryetare. Evidencat që i keni që i kam pa dhe unë  
8 gjatë procesit gjyqësor janë të gjitha -- qëndroj prapa tyre  
9 dhe tani.

10 PY. Ku i çuat të ndaluarit pastaj?

11 PË. Nuk e di.

12 PY. Në cilën periudhë kohore ka qenë kjo qendra e ndalimit në  
13 Majac?

14 PË. Po mendoj që është gjatë kohës sa ishin bombardimet e  
15 luftës dhe është koha kur neve kemi mbyll qendrat e ndalimit.  
16 Ndoshta mund të jetë fundi i marsit ose fillimi i prillit, nuk  
17 jam i sigurtë.

18 PY. Në ç'vend në Majac ndodhej qendra e ndalimit?

19 PË. E kam ditë. E kam vizitu atë vend po tash nuk di sesi ta  
20 shpjegoj.

21 PY. Kush përgjigjej për atë qendër?

22 PË. Është personeli i policisë ushtarake.

23 PY. Ti kthehemi shkurtimisht Llapashticës. Që mbase u  
24 nënkuptua nga ato që thatë. Po aty në Llapashticë kush ishte  
25 përgjegjësi i qendrës së ndalimit?

- 1 PË. Nazif Mehmeti ka qenë udhëheqësi i policisë ushtarake.
- 2 PY. Policia ushtarake ishte përgjegjëse për qendrën e ndalimi
- 3 aty?
- 4 PË. Po.
- 5 PY. Ti kthehemi Majacit. Ju thatë që ju ka qëlluar të shkonit
- 6 në qendrën e ndalimit. Afërsisht kur ka ndodhur kjo?
- 7 PË. Nuk jam i sigurtë për kohën por unë e di që ka qenë koha
- 8 kur veç është marrë vendim për lirim të gjithë të mbajturve.
- 9 PY. Çfarë lloj vendimi?
- 10 PË. Ka pasë vendim se nuk kemi pasë kushte për mbajtjen e
- 11 tyne më tutje. Ka qenë luftë gjithëpërfshirëse dhe ne kemi
- 12 dashtë të lirohemi nga ata. I kemi lirue të gjithë të shkojnë
- 13 aty ku mundenin ku ishte popullata. Ka pasë nga ata që u kanë
- 14 bashkangjit Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ka shkue secili në
- 15 vendin e vetë, me përjashtim të një burgosuri që ka qenë
- 16 përkujdesja deri në fund të luftës.
- 17 PY. Kjo ishte arsyeja pse ju shkuat në këtë qendrën e
- 18 ndalimit në atë rast?
- 19 PË. Nuk e di pse kam shkuar.
- 20 PY. Keni shkuar një herë apo më shumë se një herë?
- 21 PË. Unë e di që kam qenë një herë. Tash më kujtohet që kam
- 22 qenë një herë.
- 23 PY. Afërsisht, sa njerëz janë mbajtur aty të ndaluar kur keni
- 24 vajtur, kur keni shkuar?
- 25 PË. Nuk e mbaj mend, Kryetare.

1 PY. A ju kujtohet ndonjë prej të ndaluarve që ishin aty në  
2 atë kohë?

3 PË. Më kujtohet ka qenë një i përfolur shumë i quajtur Enver  
4 Sekiraqa. Kjo më kujtohet ngase është përfolur shumë më vonë,  
5 jo se aty ku kam qenë.

6 PY. Kur thoni më vonë, e keni fjalën për ato që keni mësuar  
7 gjatë gjyqit, gjatë gjykimit?

8 PË. Ka mujt edhe gjatë gjyqit, po më vonë kam mbas lufte,  
9 domethënë. S'po e kujtoj momentin pse mu kujtu, pse e kam  
10 mësuar që ka qenë ai.

11 PY. Pra, besoj pak kohë pas lufte në një farë mënyre mësuar  
12 se ai ishte një prej atyre të mbajturve aty, kështu?

13 PË. Mund të thuhet kështu.

14 PY. Kush ishte me ju kur shkuat në këtë qendrën e ndalimit në  
15 Majac?

16 PË. Me siguri kam qenë i shoqëruar nga ndonjë ushtar. Nuk jam  
17 i sigurtë.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani është një moment i mirë për  
19 të ndërprerë punën për të bërë pushim, të nderuar Gjykatës.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
21 tani do të bëjmë pushimin e mëngjesit për gjysëm ore.

22 Mund ta shoqëroni dëshmitarin.

23 Mos flisni me askënd për këtë çështje jashtë sallës së  
24 gjyqit.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
2 çaktivizuar].

3 --- Pauza fillon në orën 10.59

4 --- Seanca rifillon në orën 11.30

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara sesa  
6 të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 40746 [sipas  
7 përkthimit], Trupi Gjykses do japë vendimin e vet lidhur me  
8 kërkesën e ZPS-së për ndryshimin e listës së provave materiale  
9 të veta.

10 ZPS-ja ka kërkuar leje për ndryshimin e listës së provave  
11 materiale për të përfshirë dokumentet me numër identifikimi  
12 ERN SITF00069191 deri në 00069192, dhe versionin origjinal në  
13 gjuhën shqipe, SITF00069190, një faqe, që synon ta përdorë  
14 gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit 4746. Do i referohem  
15 këtij dokumenti si lista e personave të ndaluar.

16 ZPS-ja parashtroi që ka dhënë njoftim në kohë dhe ka  
17 treguar shkaqe të arsyeshme për shtimin e këtij dokumenti në  
18 listën e provave materiale dhe se Mbrojtjes nuk i shkaktohet  
19 cenim nga shtimi i këtij dokumenti.

20 Mbrojtja e Thaçit, e Veselit dhe e Krasniqit nuk e  
21 kundërshtuan këtë kërkesë ndërkohë që Mbrojtja e Selimit  
22 kundërshtoi kërkesën e ZPS-së duke argumentuar se harresa e  
23 shtimit të këtij dokumenti nuk përbën shkak për të ndryshuar  
24 listën e provave materiale.

25 Trupi Gjykses vëren se lista e personave të ndaluar

1 përmban informacion për çështje të cilat në përgjithësi janë  
2 me rëndësi për pretendimet e ngritura në aktakuzë.

3 Trupi Gjykses më tej vëren se ZPS-ja ka treguar se synon  
4 të përdorë listën e personave të ndaluar me dëshmitarin 04746.

5 Trupi Gjykses për rrjedhojë është i bindur që lista e  
6 personave të ndaluar *prima face* është me rëndësi dhe  
7 mjaftueshmërisht e rëndësishme për të justifikuar shtimin me  
8 vonesë të këtij dokumenti në listën e provave materiale.

9 Në lidhje me ndikimin e listave të personave të ndaluar  
10 për përgatitjen e të akuzuarve për procesin gjyqësor, Trupi  
11 Gjykses njofton, apo thekson, se lista e personave të ndaluar  
12 është nxjerrë dhe i është bërë e ditur Mbrojtjeve të të  
13 akuzuarve në pajtim me Rregullën 102(3) dhe 103, më datë 21  
14 qershor 2021, në versionin në anglisht [sipas përkthimit], më  
15 11 nëntor 2022 dhe në versionin në anglisht. Pra, më 21  
16 qershor 2021, është thënë në versionin në shqip, dhe në nëntor  
17 është në versionin anglisht.

18 Ky është një dokument që ka të bëjë me aspekte që kanë të  
19 bëjnë me prova të ZPS-së, ka natyrë të ngjashme me dokumentet  
20 e tjera të nxjerra nga ZPS-ja dhe që janë pjesë e listës së  
21 provave materiale dhe është një dokument vetëm prej një  
22 faqeje, në versionet në shqip dhe në anglisht.

23 Mbrojtja ka pasur njoftim të mjaftueshëm sa i takon  
24 kërkesës së ZPS-së dhe sa i takon listës së personave të  
25 ndaluar.

1 Trupi Gjykses vëren se dokumenti ka ekzistuar dhe ka qenë  
2 në zotërim të ZPS-së për vite. ZPS-ja mund, dhe duhet në fakt,  
3 të kishte kërkuar leje për ndryshim të listës së provave  
4 materiale më herët, megjithatë Trupi Gjykses vëren pranimin e  
5 singertë të ZPS-së për faktin që e kishte anashkaluar apo e  
6 kishte harruar këtë dokument.

7 Trupi Gjykses po ashtu, sa i takon parashtrimin të  
8 Mbrojtjes së Selimit që thotë që baza është në pikëpyetje për  
9 sa i takon, pra vlefshmërisë së arsyeve për pranimin e këtij  
10 dokumenti. Megjithatë, Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja e  
11 Thaçit, Mbrojtja e Selimit dhe Mbrojtja e Krasniqit nuk  
12 kundërshtuan kërkesën e ZPS-së. Duke marrë parasysh mungesën e  
13 cenimit për Mbrojtjen, natyrën e kufizuar të informacionit që  
14 përmban dokumenti dhe faktit që thelbi i informacionit që  
15 jepet në këtë dokument reflektohet edhe në dokumente të tjera  
16 që janë në listën e provave materiale, dhe fakti që dokumenti  
17 ka qenë në zotërimin të Mbrojtjes për vite, Trupi Gjykses  
18 është i përgatitur që të japë leje për ndryshimin e listës së  
19 provave materiale në këto rrethana përjashtimore.

20 Pra, Trupi Gjykses autorizon shtimin e listës së  
21 personave të ndaluar në listën e provave materiale të ZPS-së  
22 dhe përdorimin e këtij dokumenti me dëshmitarin 04746. Trupi  
23 Gjykses urdhëron ZPS-në të dorëzojë listën e provave materiale  
24 të ndryshuar, jo më vonë se sa të mërkurën më datë 12 korrik  
25 2023 dhe urdhëron ZPS-në të nxjerrë listën e personave të



1 ndaluar për Mbrojtjen dhe mbrojtësin e Viktimave në përputhje  
2 me parashikimin e Rregullës 102(1)(b)(ii) dhe (iii), deri të  
3 mërkurën që i takon data 12 korrik 2023.

4 Këtu përfundon urdhri me gojë i Trupit Gjykues.

5 Jemi gati tani të vazhdojmë më tej me marrjen në pyetje  
6 të drejtpërdrejtë nga Prokuroria të dëshmitarit.

7 Znj. Sekretare ju lutem sillni dëshmitarin në sallën e  
8 gjyqit.

9 Ka diçka për të shtuar?

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ndërkohë që  
11 vjen dëshmitari, ndoshta është me vend që të jap qartësime që  
12 u kërkuan nga Avokati sa i takon dokumentit të përdorur në  
13 seancën e mëparshme.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
15 vazhdoni.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Konfirmoj që versioni i  
17 dokumentit që iu tregua dëshmitarit është i njëjti version i  
18 dokumentit që u shfaq këtu në sallën e gjyqit, domethënë,  
19 dokumenti që i është treguar dëshmitarit gjatë intervistimit  
20 është i njëjti me dokumentin që paraqitëm në ekran këtu. Pra,  
21 në pjesën 2, faqja 12 thuhet që Rregullorja do të shënohet si  
22 prova materiale numër 1 për këtë intervistë.

23 Numri ERN i dokumentit nuk përmendet në transkriptin e  
24 intervistës, megjithatë ka një njoftim zyrtar që është  
25 përgatitur menjëherë pas intervistës me dëshmitarin që e

1 identifikon provën materiale numër 1 si i njëjti dokument që  
2 mban të njëjtin numër ERN-je që unë përmenda sot.

3 Shpresoj që të kem qenë mjaftueshmërisht e qartë.

4 [Dëshmitari fillon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

6 Dëshmitar mund të uleni.

7 Mirë se erdhët, Dëshmitar. Më dëgjoni mirë?

8 DËSHMITARI: Po.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

10 Z. Misetiç.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

12 I jemi mirënjohës Prokurorisë për qartësimin e shpejtë.

13 Nuk e di në qoftë se mund të na japin një numër ERN-je për  
14 shënimin përgatitor që na është dhënë në mënyrë të tillë që të  
15 mund ta shikojmë referencën në këtë dokument.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Njoftimi zyrtar nuk është nxjerrë  
17 si dokument për juve, por do të bëjmë organizimet e nevojshme  
18 në mënyrë të tillë që ta marrin masa më parë të gjitha palët  
19 për këtë dokument.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

21 Dëshmitar, do vazhdojmë më tej. Prokuroria do të vazhdojë  
22 me pyetjet e veta. Fjala për ju, z. Lawson.

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

24 PY. Përpara se sa të bënim pushimin, po diskutonim për disa  
25 nga qendrat e ndalimit ose vendet ku gjendeshin disa prej

1 qendrave të ndalimit. Dua që të kalojmë tek Patoku [sipas  
2 përkthimit] /Potoku/. Pyetja ime është kjo: A ke qenë  
3 ndonjëherë atje?

4 PË. Po, kam qenë shumë herë.

5 PY. A ka pasur ndonjë bazë të UÇK-së atje?

6 PË. Po.

7 PY. Cila bazë ose çfarë ka pasur atje? Cila ka qenë baza që  
8 ka qenë atje, ose çfarë ka pasur?

9 PË. Disa prej njësive të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,  
10 varësisht prej kohës, cila ka qenë.

11 PY. A mund të na thoni më konkretisht se cilat njësite kanë  
12 qenë, në qoftë se është e mundur? Dhe po ashtu ju lutem na  
13 thoni dhe kohën, periudhën kur ka ndodhur kjo?

14 PË. Nuk më kujtohen specifikat, por ka qenë deri -- tetori --  
15 sigurisht, deri në prill 1999. Prej tetorit 1998, deri në  
16 1999.

17 PY. A ka pasur edhe një spital aty?

18 PË. Po, ka qenë spitali ushtarak i zonës.

19 PY. A është përdorur për parkimin e automjeteve?

20 PË. Po, ka qenë edhe një parking për automjetet e logjistikës  
21 aty afër spitalit.

22 PY. A keni patur si zonë juve automjete të mjaftueshme?

23 PË. Nuk ka pasë të mjaftueshme, por meqë ne kishim  
24 kryeqytetin, Prishtinën, afër, ata na jepnin donacione shumë  
25 për regjionin tonë dhe kemi qenë -- ka pasë automjete.

1 PY. Si i merrnit, si i siguronit automjetet? Thatë që ka pasë  
2 donacione. A mund të na e shtjelloni më tej përgjigjen?

3 PË. Qytetarët nga Prishtina në forma të ndryshme mobilizonin  
4 dhe binin të mira materiale për UÇK-në, gjithashtu edhe  
5 automjete.

6 PY. A e ke dëgjuar ndonjëherë emrin Floki?

7 PË. Po, më kujtohet. Po e kam dëgju.

8 PY. A e ka ndihmuar ky person në ndonjë mënyrë UÇK-në?

9 PË. Ai me disa njerëz të tjerë më është thanë që ka dhanë  
10 pjesë të logjistikës, disa automjete.

11 PY. Besoj se ju e përmendën Patokun [sipas përkthimit]  
12 /Potokun/ si një prej vendeve ku njerëzit mbaheshin të  
13 ndaluar, si një prej qendrave të ndalimit, është e saktë kjo?

14 PË. Po, kanë mujtë edhe të mbahen.

15 PY. Në çfarë zone brigadash bënte pjesë Patoku?

16 PË. Ka qenë ndarja e Brigadave 151 me 152, dhe kanë qenë  
17 njësitet e zonës siç është njësiti i sanitetit.

18 PY. A është ndaluar apo a është arrestuar ndonjë brenda zonës  
19 së Llapit për shkak të motiveve keqabërëse, ose  
20 mosmarrëveshjeve private, zënieve private?

21 PË. Po.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, kundërshtoj këtë  
23 pyetje për shkak të mungesës së themelësisë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

- 1 PY. Mund t'i përgjigjeni pyetjes. Faleminderit.
- 2 PË. Ju thashë se po, ka pasë.
- 3 PY. A ju kujtohet ndonjë rast konkret lidhur me këtë?
- 4 PË. Më kujtohen që është përfolë dy-tre raste për zënka  
5 ndërmjet veti, fshatarët ndërmes veti, dhe ne kemi ndërhy.
- 6 PY. Dhe në raste të tilla, pra kur fshatarët ishin të  
7 përfshirë në zënka në mes vetes, ju a kujtoni që t'i keni  
8 ndaluar ata, t'i keni arrestuar ata?
- 9 PË. I kemi ndaluar, dhe sa janë qetësu, dhe i është tërheqë  
10 vërejtja.
- 11 PY. Ndalimi i bashkëpunëtorëve a ishte pjesë e politikave të  
12 UÇK-së?
- 13 PË. Jo politika, por ka pasë raste kur kanë qenë të ekspozuar  
14 afër vijës të frontit, apo afër vendeve ku mund të na  
15 rrezikonin, dhe ne kemi arrestuar edhe ata.
- 16 PY. Kur thoni që "nuk ka qenë politikë", çfarë doni të thoni  
17 me këtë?
- 18 PË. S'ka qenë kurrfarë, asnjë urgjencë, për ne të merremi me  
19 të tilla punë. Por tani meqë jam kenë e ftuar, ne po flasim  
20 për këto punë. Por këto punë ishin punë që ne në përgjithësi  
21 nuk mendonim shumë për këtë çështje. Nuk kanë qenë prioritetet  
22 tona.
- 23 PY. Pra mund të mos ketë qenë prioritet për juve, megjithatë  
24 ishte praktikë që përdorej, apo jo?
- 25 PË. Ne e kemi përdorë aty ku jemi rrezikuar nga ata.

1 PY. Për këtë gjë Shtabi i Përgjithshëm a ka dhënë udhëzime?

2 PË. Nuk më kujtohet. Ata kanë mundë të japin, por mua nuk më  
3 kujtohet.

4 PY. A ju kujtohet që Shtabi i Përgjithshëm të ketë thënë  
5 ndonjë gjë për bashkëpunëtorët, apo për mënyrën se si duhet të  
6 trajtoheshin ata?

7 PË. Gjatë seancave që kam pas në gjyq, është paraqitë një  
8 dokument dhe nga atëherë më është e njohur se ka qarkullu një  
9 dokument për ndalimin që të punojnë ata kundër Ushtrisë  
10 Çlirimtare të Kosovës. Por diskutime në Shtab të Përgjithshëm  
11 nuk e mbaj mend që ka pasë për këtë çështje. Së paku, jo kur  
12 unë isha aty.

13 PY. A e keni fjalën për komunikatat që janë nxjerrë nga UÇK-  
14 ja që përmendnin bashkëpunëtorët?

15 PË. Po, edhe komunikatat. Por edhe më duket çka është një  
16 udhëzim është paraqitë në seancat e mëhershme që gjatë  
17 procesit kur unë e kisha. Unë ju kam thanë që gjatë procesit  
18 që kemi kaluar, unë qëndroj prapa të gjitha atyre fjalëve që  
19 kam thanë atëherë. Domethënë, ju japi përparësi se në kohë  
20 ishte më afër.

21 PY. E vlerësoj këtë gjë. Megjithatë, do ju kujtoj sipas  
22 nevojës se çfarë është thënë në ato deklaratat e mëparshme.  
23 Çfarë thuhej në komunikata sa i takon bashkëpunëtorëve?

24 PË. Nuk mund të flas diçka specifike, por me siguri se --  
25 është parashikuar që mund të rrezikojnë trupat tona, e të kemi

1 kujdes për këto.

2 PY. Komunikatat a përmbanin paralajmërime për  
3 bashkëpunëtorët?

4 PË. Ato janë publike, nuk më kujtohen. Por komunikatat kanë  
5 qenë edhe me një dozë propagandistike për Ushtrinë Çlirimtare  
6 të Kosovës, për me forcu prezencën tonë dhe angazhimin tonë  
7 për lirinë e vendit.

8 PY. A i keni përdorur komunikatat brenda zonës kur po  
9 organizoheshit si njësi?

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtoj, sepse nuk ka  
11 themelshmëri. Deri tani themeli është që komunikatat i ka parë  
12 gjatë gjykimit, ndërkohë që nuk ka specifikim tjetër sa i  
13 takon bazës së pyetjes. Do kërkoja që të bëhet një pyetje  
14 konkrete që ka të bëjë me bazën e njohurisë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Së pari po  
16 pyet se çfarë ka parë në proces gjyqësor tani.

17 Megjithatë, në qoftë se keni informacion që ka parë  
18 ndonjë gjë të tillë më herë, ju lutemi bëjeni këtë pyetje.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, po  
20 mundohem që të mbaja seancën e hapur, megjithatë kam një  
21 deklaratë të mëhershme që mund t'ia tregoj dëshmitarit për t'i  
22 rifreskuar kujtesën. E kam fjalën për Pjesën 3, faqe 18 [sipas  
23 përkthimit] e intervistës për ZPS-në.

24 Nuk e di në qoftë se doni që të paraqitet në ekran. Në  
25 qoftë se po, mund ta bëjmë dhe këtë.

1           Z. MISETIC: [Përkthim] Po, mendoj se është e rëndësishme  
2 -- që t'i tregohet dëshmitarit. Kjo është një çështje që do ta  
3 trajtojmë dhe ne në kundërpyetjet tona, kështu që është mirë  
4 që dëshmitarit t'i tregohet kjo pjesë e intervistës në mënyrë  
5 të tillë që ta ketë më të qartë dëshmitari se çfarë po flasim.

6           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare, ju  
7 lutem paraqiteni në ekran.

8           GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndoshta numri i referencës  
9 është ERN 082894-TR-ET.

10          ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, është e saktë. Në fakt po  
11 kontrolloja në qoftë se kemi referencën e duhur edhe në  
12 versionin në gjuhën shqipe. Sigurisht, domethënë, le të  
13 paraqiten dokumentet edhe të shohim se si do të vazhdojmë më  
14 tej.

15          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mjafton me  
16 kaq besoj. Të gjithë mund ta lexojnë. Dhe përderisa dëshmitari  
17 nuk e lexon dot, mund t'ia lexoni atij.

18          ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Pra, ndërkohë që do të paraqitet  
19 dokumenti në versionin në anglisht, do të vazhdojmë me leximin  
20 për dëshmitarin.

21          PY. Pyetja që ju bëhet është kjo:

22                "Kur vendosi Shtabi i Përgjithshëm që duhet të kishte një  
23 politikë për ndalimin e bashkëpunëtorëve?"

24                Përgjigjja që ju jepni është:

25                "Ka pasur komunikata ku kishte paralajmërime që janë



1 dhënë përpara se sa të fillonte edhe lufta dhe ne i kemi  
2 përdorur këto komunikata për riorganizimin tonë. Me sa më  
3 kujtohet, që nga komunikatat e para, janë dhënë paralajmërime  
4 për bashkëpunëtorët.”

5 A është e saktë kjo, z. Mustafa?

6 PË. Po, tani po flasim për vitin 1996-1997.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërktoj ndjesë për faktin që po  
8 ju ndërpres, por a mund të citohet i plotë paragrafi? A mund  
9 të vazhdohet të lexohet deri në fund të faqes dhe rreshtat e  
10 parë, fjalët e para të faqes tjetër në mënyrë të tillë që të  
11 japim më shumë kontekst për atë çfarë përgjigje ka dhënë  
12 dëshmitari?

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, mund ta bëjmë këtë gjë.

14 PY. Këtu vazhdon më tej:

15 “PY. Por kur ka ndodhur që Shtabi i Përgjithshëm ka  
16 vendosur që duhet të ketë një politikë për ndalimin e  
17 bashkëpunëtorëve?”

18 Përgjigja juaj është si më poshtë:

19 “PË. Jam i sigurt që do ta keni në provat tuaja,  
20 dokumentat tuaja, këtë gjë sepse kjo është diçka që është  
21 njohur publikisht. Megjithatë nuk mund t’ju them me siguri  
22 kohën. E di që kemi marrë letra që thonin që na duhej që të  
23 kujdeseshim për këtë lloj gjëje”.

24 “PY. A ju kujtohet se kur ka ndodhur kjo dhe në çfarë  
25 rrethanash ka treguar Shtabi i Përgjithshëm që bashkëpunëtorët

1 do të ndaloheshin?"

2 Përgjigjja është kjo:

3 "PË. Nuk më kujtohet. Besoj se do ketë qenë pas  
4 ofensivës së shtatorit. Ndoshta kjo është zbatuar kryesisht në  
5 Dukagjin dhe Drenicë ku ka pasur shumë qytetarë shqiptarë që  
6 do të dëmtonin luftën në një mënyrë ose në një mënyrë tjetër.  
7 Megjithatë, fatmirësisht në regjionin tim kjo ka qenë shumë e  
8 rrallë."

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

10 PY. Të flasim për komunikatat --

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, data  
12 ishte -- a bëhet fjalë për 1998? E di që nuk e ka thënë  
13 dëshmitari, por ofensivën që përmendët, a bëhet fjalë për  
14 ofensivën e vitit 1998?

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, ofensiva ishte në shtator  
16 1998.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mendoj që  
18 është më mirë që të përcaktojmë vitin njëherë, dhe pastaj të  
19 vijojmë më tej.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Atëherë, duke iu kthyer edhe një  
21 herë komunikatave, ju na keni thënë në përgjigjet tuaja që ka  
22 pasur paralajmërime në këto komunikata dhe që i keni përdorur  
23 komunikatat për riorganizimin tuaj brenda, për riorganizimin e  
24 zonës domethënë, a është e saktë kjo?

25 PË. Tani znj. Prokurore e kam të kjartë. Kjo bëhet fjalë për

1 vitin 1998. Mbas ofensivës në Dukagjin dhe në disa pjesë të  
2 Kosovës, janë paraqitë njësitet nga kolona e pestë. Forcat  
3 armike kanë mobilizuar, janë bo sikur po mobilizojnë qytetarët  
4 e Kosovës, dhe të luftojnë forcat tona. Këto janë raste që nuk  
5 e kanë përfshi regjionin tim, nuk ka pasë kësi njësitate, por  
6 atëherë në atë kohë janë paraqitë dhe në bazë të asaj nevoje  
7 besoj që është lëshuar një komunikatë, rekomandim apo si doni  
8 e quajmë. Ka qenë një ordinatore publike në atë kohë.

9 PY. Përveç deklaratave të përgjithshme që ka dhënë Shtabi i  
10 Përgjithshëm, a ka dhënë udhëzime për komandantët e zonave  
11 Shtabi i Përgjithshëm sa i takon ndalimit të bashkëpunëtorëve?  
12 PË. Jo, znj. Prokurore, nuk e mbaj mend.

13 PY. A keni qenë ndonjëherë i pranishëm me anëtarë të Shtabit  
14 të Përgjithshëm kur është diskutuar tema e bashkëpunëtorëve?

15 PË. Nuk e kujtoj, znj. Prokurore. Kanë qenë shumë tema të  
16 tjera më të rëndësishme për ne. Edhe nëse është biseduar, unë  
17 s'e kujtoj.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshiroj që  
19 të paraqitet një pjesë e një deklaratë të mëhershme. Do të jap  
20 referencën dhe më pas mund të kërkoj paraqitjen e saj në ekran  
21 përpara nesh.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Është 082894-TR-ET, Pjesa 3,  
24 faqja 20.

25 PY. Pyetja që ju bëhet është kjo:

1 "Por për Shtabin e Përgjithshëm, për Shtabin e  
2 Përgjithshëm të UÇK-së, që mbulonte të gjithë Kosovën,  
3 bashkëpunëtorët dhe rreziku që paraqisnin ata ishte shumë  
4 real, është e vërtetë kjo?"

5 Përgjigjja që jepni është si më poshtë:

6 "Po, dhe unë kam qenë në Shtabin e Përgjithshëm kur është  
7 diskutuar kjo çështje dhe e di që e kanë nxjerrë këtë. Arsyeja  
8 që pse e kanë nxjerrë këtë është sepse ata kishin parë në  
9 terren se çfarë po ndodhte dhe që njerëzit po bëheshin pengesë  
10 e madhe. Unë kam qenë aty i pranishëm kur është diskutuar dhe  
11 e di që kjo gjë është bërë, po."

12 A të kujton ndonjë gjë kjo lidhur me faktin në qoftë se  
13 ke qenë i pranishëm në mbledhje së bashku me anëtarë të  
14 Shtabit të Përgjithshëm kur është diskutuar tema e  
15 bashkëpunëtorëve?

16 PË. Mendoj që është e njëjta gjë që folëm paraprakisht.

17 PY. Ishit i pranishëm në atë takim në Shtabin e Përgjithshëm  
18 kur është diskutuar kjo temë?

19 PË. Sigurisht se kam qenë --

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] Një minutë, një minutë.

21 Duhet, nëse do të bëhet kjo pyetje, kërkoj që të  
22 paraqitet e gjithë pjesa, edhe jo në mënyrë kështu  
23 përzgjedhëse.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Edhe unë ngrihem për të treguar se  
25 ka dhe një version në shqip dhe ne e kemi zakon që t'i

1 vendosim në ekran edhe në shqip që t'i lexojnë vetë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ta paraqesim  
3 dhe version shqip që dëshmitari ta lexojë. Do ta lexojmë të  
4 gjithë faqen.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do ta gjejmë ndërkohë versionin  
6 shqip. Ndërkohë unë po vazhdoj të lexoj faqen në anglisht.

7 PY. Pra, pyetja ishte:

8 "Na thoni hollësitë sesi është diskutuar për këtë. Kush  
9 ishte aty? Kush e diskutoi këtë çështje?"

10 Dhe përgjigjja ka qenë:

11 "PË. Kryesisht ishin nga zonat ku zhvilloheshin  
12 luftimet. Në Dukagjin, kishte shumë vende ku bashkëpunëtorët e  
13 mundshëm mund ta kenë dëmtuar luftën dhe kjo ishte një stimul  
14 apo një arsye pse kjo çështje u ngrit, u diskutua."

15 "PY. Po, ju sapo thatë -- dua hollësi z. Mustafa. Ju  
16 thatë se keni qenë personalisht i pranishëm kur janë marrë  
17 vendime në Shtabi i Përgjithshëm për çështjen e  
18 bashkëpunëtorëve dhe dua nga ju, kërkoj hollësi: Ku është  
19 diskutuar, në cilin forum dhe kush e ka diskutuar?

20 Dhe përgjigjja juaj është:

21 "Nuk është një pikë që ishte me interes për zonën time  
22 dhe nuk mbaj mend ndonjë, por e di që ky urdhër na u tha. Se  
23 kjo gjë duhet t'u përcillej njësive të ndryshme,  
24 komandantëve të brigadave, etj. Nuk më kujtohen hollësi të  
25 tjera."

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndalo një  
2 minutë.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] E gjetëm citimin në versionin  
4 shqip. Është 082894-TR, Faqja 3 [sipas përkthimit], faqja 27,  
5 që fillon në rreshtin 1.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit.

7 Është e saktë?

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po, këtë shpresoja edhe unë të  
9 ndodhte.

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

11 PY. Z. Mustafa po jua bëj edhe një herë pyetjen: Keni qenë i  
12 pranishëm në takimin me Shtabin e Përgjithshëm kur është  
13 diskutuar çështja e bashkëpunëtorëve?

14 PË. Është tema që shtjelluem më herët z. Prokurore dhe  
15 pajtohem me gjithçka që kam thënë më herët. Unë kam pranue ose  
16 kam mund të jem anëtar në Shtabin e Përgjithshëm kur është  
17 folë kjo temë, por pa interes për mua. Edhe koha kur ka ardhë  
18 kjo është mbas ofensivës që folëm më herët.

19 PY. Pra, përgjigja është "po", keni qenë i pranishëm në këtë  
20 takim në Shtabin e Përgjithshëm kur është diskutuar kjo temë?

21 PË. Po, po, besoj që po.

22 PY. Ku mbaheshin këto takime, këto mbledhje?

23 PË. Takimet e Shtabit të Përgjithshëm janë mbajtur në malet e  
24 Berishës, u kemi thanë ne.

25 PY. Kush tjetër ka qenë i pranishëm në këto takime?

1 PË. Shtabi i Përgjithshëm organizonte takime me komandantët e  
2 zonave.

3 PY. Ju kujtohet se cilët anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm  
4 ishin të pranishëm në takimin apo takimet në të cilat është  
5 diskutuar tema e bashkëpunëtorëve?

6 PË. Specifikisht për këtë takim, unë nuk po e kujtoj. Por di  
7 që ka mundë me qenë z. Jakup Krasniqi, Ramë Buja, edhe ndonjë  
8 tjetër tash, por saktësisht nuk më kujtohen. Dhe takimet kanë  
9 qenë të rralla në këtë kohë dhe temat për të cilat kemi folë  
10 kanë qenë krejt në prioritetet e tjera.

11 PY. Ju përmendët një urdhër. Morët ndonjë gjë me shkrim  
12 lidhur me ndalimin e bashkëpunëtorëve? E kam fjalën me shkrim  
13 nga Shtabi i Përgjithshëm.

14 PË. Nuk më kujtohet. Mund të ndodhë edhe kam marrë, por nuk  
15 më kujtohet.

16 PY. Do t'ju ndihmonte po t'ju tregoja përsëri një pjesë nga  
17 kjo deklarata juaj e mëparshme? Z. Mustafa, do t'ju ndihmonte  
18 po t'ju tregoja pjesë nga kjo deklarata?

19 PË. Nëse e kam thanë që e kemi marrë letrën, me siguri që e  
20 kemi marrë.

21 PY. Pra e pranoni që keni marrë urdhër me shkrim lidhur me  
22 çështjen e ndalimit të bashkëpunëtorëve nga Shtabi i  
23 Përgjithshëm.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem na tregoni citimin që ta  
25 kontrollojmë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Padyshim, është Pjesa 3, faqja  
3 29.

4 PY. Ju kanë dhënë udhëzime për zbatimin e atij urdhri? Mund  
5 ta bëj përsëri pyetjen. Ju dhanë udhëzime për zbatimin e këtij  
6 urdhri?

7 PË. Unë e kam thanë atëherë besoj që nuk ka qenë temë  
8 interesante për mua për me e mbajtur mend. Nuk më kujtohet.

9 PY. Për shembull, ju kërkuan që t'ua shpërndanit komandantëve  
10 që të siguroheshit që të zbatohet?

11 PË. Nuk besoj që kemi folë për ato detaje.

12 PY. T'i kthehem pjesës së transkriptit që kishim pak përpara  
13 në ekran. Është Pjesa 3, faqja 20 në anglisht. Ndoshta është  
14 ende në ekran në shqip. Aty keni thënë:

15 "...E di që urdhri na u paraqit përpara. Dhe na i thanë  
16 me gojë, dhe se duhej t'jua dërgonim njësiteve të ndryshme  
17 komandantëve të brigadave, e kështu me radhë..."

18 Është e saktë kjo z. Mustafa?

19 PË. Po, nëse e kam thanë ashtu, ashtu është.

20 PY. Kush kishte autoritet për të urdhëruar arrestimin e  
21 dikujt? Më falni, përpara se të ndryshojmë temën, a mund të  
22 sqarojmë kohën kur ka ndodhur? Ju thatë në fillim të  
23 diskutimit, por për çfarë periudhe kohore flasim kur flasim  
24 për këto mbledhjet e Shtabit të Përgjithshëm ?

25 PË. Mbledhjet në Shtabin e Përgjithshëm filluen krejt vonë



1 pas ardhjes së OSBE-së dhe KDOM-it në vendin tonë. Përpara  
2 kanë qenë shumë të shkurtra dhe shumë jo komplete. Në fillim  
3 ka qenë, kryesisht, i ka udhëheqë mbledhjet, takimet, shefi i  
4 shtabit. Dikur kur ka ardhë Rambujeja --  
5 PY. Më falni që ju ndërpres z. Mustafa, por e kam fjalën për  
6 këtë moment konkret për të cilin po flasim. Për këtë takim  
7 kur u dha udhëzimi apo urdhri lidhur me ndalimin e  
8 bashkëpunëtorëve, kur është diskutuar. Kjo ndodhi pas  
9 ofensivës së shtatorit?  
10 PË. Nuk e -- duhet të jetë pas ofensivës sigurisht, por kjo  
11 duhet të jetë shumë vonë. Nuk e kam të kjartë në qoftë se më  
12 kupton.  
13 PY. Faleminderit. Kush e kishte autoritetin apo kompetencën  
14 të urdhëronte që dikush të arrestohej?  
15 PË. Komandanti i zonës dhe Komandantët e brigadave me siguri.  
16 Por unë nuk e di se na është thanë kush ka të drejtë nga  
17 Shtabi i Përgjithshëm, por unë po ju flas për praktikën në  
18 regjionin ku unë kam qenë Komandant.  
19 PY. E kuptova. Dhe ju përmendni komandantët e zonave dhe  
20 komandantët e brigadave. Këtë autoritet e kishte dhe ndonjë  
21 anëtar tjetër i komandës së zonës?  
22 PË. Ishin tek unë shef i shtabit dhe zëvendëskomandanti. Por  
23 në praktikë në shumicën e rasteve ata kanë ardhë vetë ose i  
24 kanë sjellë qytetarët, fshatarët, nga vendet ku i kanë marrë,  
25 që ishin të mobilizuar në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

1 PY. Pra, fshatarët i sillnin njerëzit tek ushtarët tuaj, tek  
2 bazat tuaja që t'i ndalonit, këtë po thoni?

3 PË. Po, ka ndodhë ashtu.

4 PY. Komanda e zonës ka marrë vendime konkrete në raste të  
5 caktuara se kush duhej arrestuar?

6 PË. Nuk më kujtohet detajisht, por është paraqitë rasti se ku  
7 po ndodh ngecje, ku ka ndërhyrje nga këta persona dhe aty për  
8 aty janë marrë ato vendime, janë të çastit, nuk janë që ne  
9 kemi pasë një strategji për ndjekjen e tyre. Edhe nuk janë  
10 shumë, gjatë gjithë luftës është numër i vogël i këtyne  
11 njerëzve.

12 PY. Nga i merrnit informatat për ata që duheshin ndaluar? Ju  
13 përmendët që i sillnin dhe fshatarët, por a kishit ndonjë  
14 burim tjetër informacioni?

15 PË. Kemi përdorë të gjitha burimet e mundshme që kanë ardhë  
16 me informu, por kryesisht kanë ardhë nga rrethi ku ata kanë  
17 jetue. Nga ambienti i tyre ku kanë ba dëme, ose kanë ba ndonji  
18 problem në rrethin ku jetojnë familjet e ushtarëve tonë, e  
19 kështu me radhë.

20 PY. Çfarë procesi ndiqej kur kryhej një arrestim?

21 PË. Nuk ka pasë proces, ka pasë thjesht ndalim për të mos  
22 dëmtuar misionin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

23 PY. Kush i ekzekutonte urdhër-arrestimet?

24 PË. Nuk ka pasë urdhra arrestimesh për me ekzekutue, por unë  
25 po them është paraqit rasti se një person është problematik

1 për shembull në një fshat, ne i kemi marrë masat dhe e kemi  
2 arrestue. S'ka pasë përgatitje dhe angazhim të trupave qysh ju  
3 mendoni, për me bo një rast të tillë, për me ndalue një  
4 person. Raste të rralla kanë qenë kur kemi angazhu njësinë për  
5 me arrestu dikë.

6 PY. Pra personat i sillnin në UÇK, dhe merrej vendim për t'i  
7 mbajtur të ndaluar, dhe kush do ta kryente këtë ndalim  
8 fizikisht?

9 PË. Policia.

10 PY. Përveç atyre që sillnin fshatarët, kishte edhe njerëz të  
11 tjerë që thirreshin për t'u paraqitur në Shtabin e UÇK-së?

12 PË. Po, ka pasë.

13 PY. Në çfarë forme bëhej kjo thirrje? Me gojë apo i merrnit,  
14 si bëhej? Apo me shkrim?

15 PË. Ka mund të ketë ndonjë rast edhe me shkrim, është  
16 drejtuar policia ushtarake, por kryesisht është bo me gojë.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dua t'ju tregoj një dokument.

18 P00171. Anglishtja ka të njëjtin numër, por në fund ka një ET.

19 PY. E shihni dokumentin që keni përpara në ekran z. Mustafa?

20 PË. Po.

21 PY. Është një formular model për fletëthirrje, apo jo?

22 PË. Me siguri stafi ka përgatitë kësi formulari, por nuk  
23 besoj që është praktikue. Ka mund të jetë praktikue, por nuk  
24 kam informata që është praktiku ndonjëherë. Koha kur ne po  
25 demonstرونin se duhet edhe administratën dhe gjithçka të

1 rregullonim në kohën e luftës.

2 PY. Në qoshen e majtë është shkruajtur "Zona operative e  
3 Llapit", apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. Më poshtë thotë, "Policia Ushtarake", kështu?

6 PË. Po s'e kundërshtoj këtë dokument. S'është asgjë që do ta  
7 kundërshtoj.

8 PY. Dhe ju e pranoni se njerëzit thirreshin si me gojë,  
9 ndonjëherë dhe me shkrim, kështu?

10 PË. Kanë mundë edhe me shkrim, por mua s'më kujtohet që  
11 dikush është thirrë me shkrim.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga  
13 ekрани. Faleminderit.

14 PY. Kur njerëzit mbaheshin të ndaluar, kishte dikë që ishte  
15 përgjegjës për t'i regjistruar ata?

16 PË. Po, me siguri, po.

17 PY. Kush e ka bërë këtë punë?

18 PË. Nuk e di, ka qenë punë e administratës, policisë.

19 PY. A fliste dikush me njerëzit e ndaluar?

20 PË. Ka pasë raste me siguri që kanë folë.

21 PY. I merrnin në pyetje lidhur me arsyet e ndalimit të tyre?

22 PË. Nuk ka qenë kjo praktikë.

23 PY. A u jepej mundësia të jepnin shpjegime për akuzat që u  
24 bëheshin?

25 PË. S'kemi pasë proces të organizuem kundër tyre, znj.

1 Prokurore, por unë s'e përjashtoj mundësinë që s'kanë folë  
2 ushtarët kur kanë qëndru bashkë me ta, kanë qenë duke punue,  
3 me siguri atyne u është marrë emri, mbiemri dhe kush janë. Nuk  
4 po përjashtoj që ka mujtë me kanë dhe pyetje, por jo diçka  
5 proces specifik lidhur me këto raste të tyne.

6 PY. Dhe kush mund ta bënte këtë punë? Ju thatë ushtarët, por  
7 a ishte një njësi specifike apo një person i caktuar?

8 PË. Ata që merreshin me administrim, policia ushtarake.

9 PY. Kishin avokatë mbrojtës të ndaluarit?

10 PË. Znj. Prokurore, nuk ka pasë procese. Ata thjesht janë  
11 ndaluar për të mos dëmtuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe  
12 misionin tonë për liri.

13 PY. Pra, do të thoni "jo"? Kjo është përgjigja?

14 PË. Nuk ka pasë proces asnjëherë në zonën operative të Llapit  
15 për ata që kemi mbajtë. Thjesht janë ndaluar me qenë kundër  
16 misionit të lirisë derisa ka kaluar rreziku.

17 PY. Me këtë kuptoj që nuk kishte ndonjë gjykatës për të  
18 vendosur për çështjen e personave të ndaluar, kështu?

19 PË. Jo, nuk ka pasë.

20 PY. Dhe ju thatë që s'kishte ndonjë proces. Pra, s'kishte  
21 proces që një i ndaluar ta kundërshtonte ndalimin e tij,  
22 kështu?

23 PË. Znj. Prokurore, ata janë ndaluar thjesht për arsye  
24 ushtarake derisa ka kaluar rreziku. Asgjë tjetër s'ka pasë  
25 lidhur me ta. Ata i kanë mundë me i vizitu familjarët e tyne,

1 organizatat e Kryqit të Kyq, OSBE, dhe Këshilli për Mbrojtjen  
2 e të Drejtave të Njeriut.

3 PY. A e di kush është Sokol Dobruna?

4 PË. Po.

5 PY. E keni takuar në 1998 apo në 1999?

6 PË. Jam takuar me të në Shtabin e Përgjithshëm, por unë nuk e  
7 kam ditë pozicionin e tij që thuhej që ka qenë kryetari i  
8 gjykatës dhe e marr vesh pas luftës që është përfolë. Ai ka  
9 qenë referent pranë Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.

10 PY. A është informuar shtabi i Llapit për këta të ndaluarit?  
11 Mbahej i informuar, informohej?

12 PË. Jo specifikisht, por kur ka pasë çka të flitet për ta,  
13 është raportuar nga ata që kanë qenë përgjegjës për mbajtjen e  
14 tyre.

15 PY. Kush përgjigjej në komandën e zonës, për të qenë i  
16 informuar lidhur me gjendjen e të ndaluarve? Pra, te kush  
17 raportohet?

18 PË. Te shefi i shtabit, ka mundë edhe zëvendësi im edhe unë  
19 të drejtpërdrejtë. Por ai që raportonte ka qenë Nazif Mehmeti.

20 PY. Ai paraqiste raporte në lidhje me të ndaluarit?

21 PË. Jo raporte. Informim të thjeshtë. Rrëfim të shpejtë. Kur  
22 ka qenë e nevojshme ka qenë shumë rrallë informata.

23 PY. Çfarë lloji informacioni jepete?

24 PË. Gjendjen e tyre, çfarë pune po bëjnë ata, kushtet e tyre.

25 Tash mos më lejoni me spekulim më shumë, nuk e di çfarë kanë

1 mundë me kanë, por puna rreth mbajtjes së tyre. Është 25 vite  
2 po bëhen, znj. Prokurore.

3 PY. E kuptoj.

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshiroj të paraqitet në ekran  
5 një provë materiale. Është dokumenti që u shtua sot paradite  
6 në listën e provave materiale të Prokurorisë. Referenca është  
7 SITF00069190. Dhe versioni në gjuhën angleze është  
8 SITF00069191. A mund ta kaloni më poshtë dokumentin për të  
9 parë fundin e dokumentit ju lutem? Faqja e dytë në versionin  
10 anglisht.

11 PY. A e shihni një nënshkrim në fund të këtij dokumenti, z.  
12 Mustafa?

13 PË. Po.

14 PY. A e njihni këtë nënshkrim?

15 PË. Unë, meqë e di kush ka qenë udhëheqës i policisë, se e di  
16 kënd po aludohet, se përndryshe s'e kam pa këtë dokument. Ose  
17 e kam harruar që e kam pa.

18 PY. Kush është ky personi që e ka nënshkruar dokumentin?

19 PË. Aludimi është për Nazif Mehmetin.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të shohim fillimin e  
21 dokumentit dhe faqen e parë në versionin anglisht, ju lutem.

22 PY. A është ky një lloj raporti që merrnit zakonisht nga  
23 Nazif Mehmeti?

24 PË. Nuk qenka raport, qenka evidencë e të mbajturve.

25 PY. A është ky lloji i evidencës së të mbajturve që merrnit

1 zakonisht prej tij?

2 PË. Mu ma merr mendja që e ka mbajtur ai vetë. S'kam pasë  
3 nevojë ne ta mbajmë në shtab. S'më kujtohet që kemi marrë  
4 raporte. Kësoj dokumentash i është dhënë edhe KDOM-it dhe  
5 OSBE-së. Kur kanë kërkuar kush është prej të mbajturve ne u  
6 kemi ofruar mundësi të gjithë atyne palëve të interesueme, se  
7 kush është duke u mbajtur.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshiroj që  
9 ky dokument të paraqitet si provë materiale.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
12 SITF00069190 në shqip dhe 69191 në anglisht. I lutem  
13 Sekretares të caktojë një numër prove materiale.

14 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
15 është dokumenti si provë materiale P224.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
17 Vazhdoni znj. Lawson.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

19 PY. A ishte sekret që UÇK-ja i ndalonte apo i arrestonte  
20 njerëzit, z. Mustafa?

21 PË. Jo, znj. Prokurore, ka qenë shumë e njohur publike.  
22 Kushdo që ka dashtë me ditë e ka ditë. Kanë qenë të njohura të  
23 gjitha organizatat ndërkombëtare dhe vendore të asaj kohe.

24 PY. Ju përmendët dy organizata ndërkombëtare. A ju kujtohet  
25 të jeni takuar me përfaqësues të OSBE-së lidhur me të



1 ndaluarit apo të mbajturit?

2 PË. Po, kam mundë me u taku.

3 PY. A ju kujtohet se kur ka ndodhë ky takim?

4 PË. Jo, zonja --

5 PY. [Mikrofoni çaktivizuar]

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

7 PY. A ju kujtohet se çfarë keni biseduar me ta?

8 PË. Më së shumti ata janë interesu për mirëmbajtjen e tyre  
9 dhe kështu. Por detajet s'më kujtohen. Më kujtohet një rast që  
10 me ndërhyrjen e shefit të misionit të OSBE-së në atë kohë,  
11 bashkë me shefin për politika të UÇK-së, Adem Demaçin, i kemi  
12 liruar dy nga të burgosurit.

13 PY. A ju keni dhënë qasje atyre juve në këto shtëpitë e  
14 ndalimit ose zonat e ndalimit?

15 PË. Po.

16 PY. A i lejuat atyre të takoheshin me personat e ndaluar?

17 PË. Po, besoj që po.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshiroj të paraqitet një  
19 dokument në ekran, numri është P00116. Ky dokument është në  
20 anglisht, por është një dokument që ka të bëjë me një takim  
21 ose mbledhje të organizuar më 18 shkurt 1999.

22 PY. A ju duket e njohur kjo datë z. Mustafa?

23 PË. Jo, nuk më duket, por unë besoj që ka ndodhë kësaj  
24 takimesh asokohe.

25 PY. Dhe në paragrafin e dytë të këtij dokument thuhet se:

1 "Qasja në shtëpinë e ndalimit iu refuzua pjesëmarrësve në  
2 këtë takim 'për arsye sigurie'."

3 Dhe më pas thuhet që:

4 "Qasja iu lejua personave që ishin pjesë e atij misioni  
5 që të takoheshin me disa të ndaluar."

6 A ju kujtohet kjo?

7 PË. Unë e di që të interesuarit e organizatave ndërkombëtare  
8 por edhe vendore, kanë mundë me i takue, gjithashtu edhe  
9 familjarë të tyre. Specifikisht ky rast nuk po më kujtohet.

10 PY. Ata thonë që ju keni dhënë informacione për të ndaluar të  
11 caktuar. Për shembull, thuhet që vetëm shqiptarë ka pasur  
12 nëpër këto godinat apo ndërtesat e ndalimit dhe këtu thuhet që  
13 ka pasur mesatarisht dhjetë individë të cilët janë në një  
14 formë arresti shtëpiak. A e pranoni që ju keni dhënë atyre  
15 këtë lloj informacioni?

16 PË. Me siguri ka qenë ai dokumenti që sapo diskutuam për të.  
17 S'kam kundërshtim, por nuk më kujtohet saktësisht.

18 PY. Nga e dinit ju këtë informacion për të ndaluarit?

19 PË. Unë me siguri kam qenë i përgatitur për takim, nga stafi  
20 im.

21 PY. Më poshtë në këtë dokument, autori përshkruar takimin  
22 edhe me komandantin e policisë ushtarake. Dhe aty thuhet që ai  
23 ka dhënë informacion të hollësishëm lidhur me proceset  
24 gjyqësore që zbatoheshin për të ndaluarit. A ka pasur procese  
25 gjyqësore që zbatoheshin për të ndaluarit në atë kohë?

1 PË. Jo, nuk ka pasë.

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga  
3 ekrani.

4 PY. Kush kishte kompetencë për t'i liruar të ndaluarit?

5 PË. Unë me stafin tim.

6 PY. Kush në stafin tuaj?

7 PË. Të gjithë ata njerëz të stafit që kemi folë për ta. Por  
8 jo pa dijen tonë.

9 PY. Kur thoni "të gjithë ata anëtarë të stafit që kemi  
10 biseduar", e keni fjalën për të gjithë anëtarët e komandës së  
11 zonës?

12 PË. Po.

13 PY. Kur thoni "jo pa dijeninë time", për këtë e keni fjalën?

14 PË. Pa njohurinë time personale dhe të udhëheqjes së zonës,  
15 shefit të stafit dhe zëvendësit tim.

16 PY. Ju personalisht a keni marrë vendime në qoftë se do të  
17 lironi ose në qoftë se do të vazhdonit të mbanit dikë të  
18 ndaluar? Personalisht i keni marrë këto vendime?

19 PË. Specifikisht nuk më kujtohet, por po kam marrë vendime.  
20 Ka përgatitë stafi vendime, dhe kemi marrë vendime.

21 PY. A është dhënë amnisti për sa i takon ndonjë të ndaluar  
22 të caktuar?

23 PË. S'më kujtohen hollësi, por po ashtu siç shkruan në proces  
24 më herët, ashtu ka ndodhë.

25 PY. A ju kujtohen datat kur janë marrë vendimet e amnistisë?

1 PË. Jo, znj. Prokurore.

2 PY. A bëhej fjalë për amnisti me shkrim?

3 PË. Ka mundë të jetë, por mu s'po më kujtohet si ka qenë. Me  
4 siguri ka mbajtur evidencë dikush nga stafi. Dhe për hir të  
5 mjeteve publike kemi mujtë me bë dhe me shkrim.

6 PY. Për çfarë arsyes janë dhënë amnistitë?

7 PË. Janë pushuar mundësitë e tyre, arsyet për çfarë ata kanë  
8 mundë me na rreziku.

9 PY. A ka pasur edhe problem me mbingarkimin me persona të  
10 ambienteve të paraburgimit?

11 PË. Ka mundë me kanë edhe një nga arsyet kjo. Por s'besoj se  
12 ka qenë arsye e vetme.

13 PY. Pse keni shkruar amnisti me shkrim, në vend që thjesht  
14 t'i lironit njerëzit, pse keni dhënë amnisti me shkrim?

15 PË. Me siguri kemi dashtë me dëshmue organizimin tonë edhe  
16 misionin tonë. Si gjest i mirë.

17 PY. Kujt donit t'ia demonstronit këtë gjë?

18 PË. Ma së pari popullatës për të cilën po luftonim, pastaj të  
19 tjerëve.

20 PY. E bënit këtë gjë edhe për ndërkombëtarët?

21 PË. Sigurisht që po.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të  
23 paraqiten disa dokumente. Do shohim relativisht dokumente të  
24 gjata, kështu që nuk e di në qoftë se dëshironi që të fillojmë  
25 tani apo mbase më vonë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të

2 fillojmë tani dhe të bëjmë çfarë të mundemi.

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Në rregull. Dokumenti i parë që

4 kërkoj që të paraqitet në ekran është ai me numër identifikimi

5 SITF00069018, dokumenti në anglisht ka të njëjtin numër, por

6 përfundon me ET në fund.

7 PY. Z. Mustafa, ju lutem a mund ta lexoni me zë datën e këtij

8 dokumenti?

9 PË. 31.12.1998.

10 PY. A e njihni nënshkrimin në fund të faqes?

11 PË. Po, është nënshkrimi im.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] A mund të kalojmë në faqen

13 tjetër?

14 PY. Përsëri, a e njihni nënshkrimin në fund të kësaj faqeje?

15 PË. Po, kuptoj që është i Nazif Mehmetit. Unë nuk e kam pa

16 këtë dokument ma herët, por po e shoh që është personalizuar

17 një vendim.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të kalojmë më poshtë në faqen

19 tjetër.

20 PY. Përsëri, e njëjta pyetje. A e njihni nënshkrimin në fund

21 të kësaj faqeje?

22 PË. Këtë veç po e di kënd po aludohet, dhe di kush ka qenë

23 komandanti, në bazë të kësaj e di që është Dini, komandant

24 Nazif Mehmeti. Por dokumentin nuk e kam pa ma herët.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja tjetër, që

1 është faqja e fundit.

2 PY. A e keni parë më herët këtë dokument?

3 PË. Jo, nuk po më kujtohet.

4 PY. A e kuptoni se me çfarë lidhet ky dokument?

5 PË. Është arsyetim pse një person është mbajtur -- e është  
6 liruar.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] A mund të shkojmë përsëri tek  
8 faqja e parë, ju lutem?

9 PY. Shohim këtë që është shkruar pas "Amnistisë". Ju lutem, a  
10 mund të lexoni emrin, datën kur thuhet që ky person është  
11 arrestuar dhe arsyen për arrestimin e tij. Mund ta lexoni?

12 PË. Për cilin po mendon? Për cilin?

13 PY. Për Rushit Ballovcin.

14 PË. "...i lindur më 03.06.1973, në Prishtinë, Rruga e  
15 Vushtrisë, numër 40/A, i privuar nga liria më 20.11.1998, për  
16 shkak të veprës penale falsifikim dhe bashkëpunim me  
17 bashkëpunëtorin serb me qëllim të përfitimit dhe pasurimit të  
18 paligjshëm."

19 Evidencë administrative.

20 PY. Në rregull.

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshiroj që këtë dokument ta  
22 paraqes për t'u pranuar si provë materiale.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e

1 Veselit?

2 Z. EMMERSON: [Mikrofoni çaktivizuar]

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Asgjë, nuk kundërshtoj.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
5 SITF00069018 pranohet në provë materiale.

6 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, i  
7 caktohet numri i Provës materiale 225.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kërkoj që të paraqitet një tjetër  
9 dokument. Mban numrin e identifikimit P00150. Versioni në  
10 anglishte nuk ka një numër të provës materiale që i është  
11 caktuar, megjithëse dokumenti në shqip është pranuar si provë  
12 materiale. ERN-ja në anglisht është SITF00242572.

13 PY. Z. Mustafa, a mund ta lexoni datën e këtij dokumenti,  
14 ndoshta duhet zmadhuar pak, por e lexon dot, z. Mustafa,  
15 datën?

16 PË. 17.01.1999.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Le të shkojmë në fund të faqes në  
18 versionin në shqip.

19 PY. A e njihni këtë nënshkrim?

20 PË. Po, nënshkrimi duhet të jetë i imi, por unë befasohem me  
21 këtë dokument. Nuk është formë e dokumenteve tona që unë kam  
22 nënshkrue. Forma, përmbajtja, më duket interesant.

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ta ngremë pak më sipër fletën.

24 PY. Përsëri, z. Mustafa, dëshiroj që të lexoni paragrafin e  
25 parë. Të lutem, lexoni emrin, datën dhe kohën ku thuhet që

1 personi është arrestuar.

2 PË. Emrin, nëse më lejoni, do ta kursej, sepse nuk dëshiroj  
3 të ndihet familja e tyne keq apo ai personalisht.

4 "...i lindur më 12.06.1955 në Llapashticë të Poshtme ku  
5 edhe jeton. Mbajtja në lokalet e PU-së të zonës prej  
6 04.01.1999, në ora 23.00 për shkak të dyshimit të bazuar, ka  
7 kryer veprë penale të vjedhjes."

8 PY. Faleminderit.

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kërkoj të kalojmë te një tjetër  
10 dokument. Dhe gjithashtu do i kërkoja Trupit Gjykses që të  
11 caktohet një numër prove materiale për dokumentin në versionin  
12 në anglisht.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

14 Dokumenti SITF00242572, versioni në anglisht, pranohet në  
15 provë materiale, do t'i caktohet një numër prove materiale.

16 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ky  
17 dokument do të marrë numrin e Provës materiale P150 dhe në  
18 anglisht numri është P150-ET.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, besoj që  
21 është momenti i përshtatshëm për ta përfunduar seancën e  
22 paradites.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do  
24 të marrim pushimin e drekës tani. Do të kthehem në orën  
25 14.30. Ju kujtoj të mos flisni me askënd për dëshminë që keni



1 folur para Trupit Gjykues. Sekretarja do t'ju nxjerrë nga  
2 salla e gjyqit tani. Faleminderit.

3 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson  
5 keni ndonjë çështje?

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kemi diçka organizative, në  
7 mënyrë të tillë që të mund të planifikojmë urdhrat për  
8 kundërpyetje, duke përdorur kohën më të mirë dhe për të  
9 mënjanua mbivendosjet, dëshiroj të di nga Prokuroria se edhe  
10 sa kohë i duhet në mënyrë që të mund të përfundojë pyetjet për  
11 dëshmitarin?

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të na  
13 thoni, mund të na jepni ndonjë informacion?

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Aktualisht parashikoj që do të  
15 vazhdojmë deri nesër. Mund ta rimendoj edhe një herë gjatë  
16 darkës çfarë mund të heq, megjithatë për momentin kjo është  
17 koha që mund të jap.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë, në  
19 rregull atëherë. Të paktën e dimë që do përfundojë nesër  
20 Prokuroria.

21 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.00

22 --- Rifillon në orën 14.30

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.  
24 Sekretare, silleni dëshmitarin në sallë.

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]

- 1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
2 uleni.
- 3 Dëshmitar, do të vazhdojmë me pyetjet e Prokurorisë.  
4 Znj. Lawson, keni fjalën.
- 5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar.  
6 PY. Mirëdita, z. Mustafa.  
7 PË. Mirëdita.
- 8 PY. Do të vazhdojmë aty ku e lamë përpara pushimit. Dhe po ju  
9 tregojta disa dokumente.
- 10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani dua që të paraqesim në ekran  
11 dokumentin tjetër me numër P00010 dhe ky dokument përmban edhe  
12 shqipen dhe anglishten. Ju lutem, të kalojmë në fund të  
13 dokumentit në shqip, besoj që është në faqen e dytë.
- 14 PY. A e njihni këtë nënshkrim, z. Mustafa?  
15 PË. Po. Është nënshkrimi im.
- 16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të kalojmë në faqen e parë.
- 17 PY. A mund ta lexoni datën e këtij dokumenti, ju lutem?  
18 PË. 05.04.1999.
- 19 PY. Aty përmendën emrat e 12 të ndaluarve në këtë amnisti.  
20 Por po marrim të parin. Ju lutem, lexoni emrin, në qoftë se  
21 preferoni të mos e lexoni emrin, lexoni datën që është  
22 shënuar, që është arrestuar.
- 23 PË. "...i lindur më 01.02.1943, në fshatin Bradash; mbajtja  
24 prej 18.11.1999, në orën 16:00".
- 25 PY. Pajtoheni se duket se një e ka gabim ortografik në datën

1 e arrestimit, sepse thuhet nëntor 1999. Dhe dokumenti është  
2 lëshuar në prill të 1999?

3 PË. Me siguri qenka gabim.

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dua t'ju tregoj një dokument  
5 tjetër tani. Referenca është SITF00242581; anglishtja ka të  
6 njëjtin numër, por në fund ka ET.

7 PY. Ju lutem, lexoni datën e këtij dokumenti.

8 PË. 18.01.1999.

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të kalojmë në fund të faqes, ju  
10 lutem, për të parë nënshkrimin.

11 PY. E njihni këtë nënshkrim këtu?

12 PË. Tani është njëjtë si dhe t'tjerat. Për nënshkrimin e  
13 Nazif Mehmetit.

14 PY. Paragrafi i tretë i dokumentit përmend një person që i  
15 dhanë tre muaj arrest shtëpie. Ju kujtohet se përse ia dhanë  
16 këtë masë?

17 PË. Jo, s'më kujtohet, as rasti fare.

18 PY. Paragrafi i fundit thotë masat e marra nga organet  
19 ushtarake. Çfarë masash kanë qenë këto?

20 PË. Znj. Prokurore, kjo është krekosje pak e Nazif Mehmetit.  
21 Ai ka qenë me edukim të lartë policor në ish-Jugosllavi. I  
22 kanë njoftë rregullat mirë dhe ka bërë kso dokumentesh besoj  
23 duke u krekosur. Hiç s'kemi pas kso mundësish ose kso  
24 procesesh.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshiroj që ta paraqes këtë

1 dokument si provë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
3 çaktivizuar] Ndonjë kundërshtim, pyetje?

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk ka kundërshtim.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Numri do të  
6 jetë SITF00242581, pranohet dhe i jepet një numër.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të jetë prova  
8 materiale 226, P226.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dua që të paraqesim një dokument  
11 tjetër. Për arsye privatësie nuk duhet ta transmetojmë.  
12 Referenca është SITF00243091. Anglishtja ka të njëjtin numër,  
13 por në fund ka një ET.

14 Të nderuar Gjykatës, në fakt dua të lexoj me zë disa  
15 emra. Prandaj do të ishte mirë të kalonim në seancë private.  
16 Do të zgjasë pak minuta.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në  
18 seancë private për të mbrojtur emrat e dëshmitarëve.

19 [Seancë private]

20 [Seancë private teksti i fshirë]

21

22

23

24

25

## Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04746 (Vijim) (Seancë private)  
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdon)

Faqe 85

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

## Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04746 (Vijim) (Seancë private)  
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdon)

Faqe 86

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po e përsëris pyetjen: A erdhi

22 një moment kur u desh të merrnit një vendim për lirimin e të

23 mbajturve apo jo?

24 PË. Po, erdhi.

25 PY. Kur ishte, kur ndodhi kjo?

1 PË. Mua më duket që këto dokumente komunikojnë me kohën, që  
2 sapo i pamë. Ishte momenti kur ne nuk mund të, nuk ishim të  
3 sigurt as vetë dhe nuk mund të mirëmbanim shtëpitë e ndalimit.  
4 Me përjashtim të një personi, të gjithë të tjerët janë liruar.

5 PY. E keni fjalën për prillin e vitit 1999?

6 PË. Po.

7 PY. Ju përmendët se vetëm njëri i mbajtur nuk u lirua. A mund  
8 ta jepni emrin e tij nëse mund ta jepni në seancë publike?

9 PË. Mundem, është, ka qenë publike. Kam fol shumë herë në  
10 publik për të. Ishte Fadil Sulejviqi.

11 PY. Dhe ju po thoni se ai vazhdoi të mbahej i ndaluar në atë  
12 kohë?

13 PË. Kisha caktuar polic ushtarakë që do të merreshin me  
14 kujdesin për të deri në fund lufte. Ai nuk ishte tani i  
15 arrestuar, por ishte nën kujdesin e njerëzve të caktuar.

16 PY. Përse mbeti nën kujdesin, pse kishte nevojë ai për  
17 kujdes?

18 PË. Ka qenë njeri, person i rëndësisë të veçantë; punëtor i  
19 sigurimit shtetnor serb.

20 PY. Nuk do të kishte qenë për të e sigurt thjesht të kthehej  
21 në Prishtinë?

22 PË. Nuk ishim edhe ne të sigurt që ai nuk mund të na dëmtonte  
23 në çdo moment. Kishte njohuri të madhe për Ushtrinë Çlirimtare  
24 të Kosovës edhe gjithë organizmin.

25 PY. Po ai, u bë anëtar i UÇK-së?



1 PË. Jo, asnjëherë.

2 PY. Do t'i kthehemi z. Sulejviq pas një çasti. Kush e zbatoi  
3 urdhrin për lirimimin e të mbajturve?

4 PË. Besoj se stafi komandues, stafi im.

5 PY. E keni fjalën shtabin e zonës, komandës së zonës të  
6 policisë ushtarake, mund të jeni pak më konkret?

7 PË. Dikush nga shtabi i zonës apo policia. Tash nuk më  
8 kujtohen, por janë të faktume në procesin që ishte kundër  
9 nesh. Janë të gjitha të listume dhe të evidentume. Nuk kisha  
10 dashtë me shtu kurrgjë në këtë drejtim.

11 PY. A ndodhi ndonjëherë që ndonjë prej të mbajturve është  
12 liruar dhe pastaj është ndaluar përsëri?

13 PË. Jo pas kësaj kohe nuk kemi pas më shtëpi ndaluese.

14 PY. Nuk e kam fjalën pas kohës kur thatë që janë liruar të  
15 gjithë të mbajturit. Përpara kësaj kohe ka pasur raste kur  
16 ndonjë prej të mbajturve është liruar dhe është pastaj  
17 riarrestuar, pra, arrestuar përsëri?

18 PË. Më kujtohet një rast gjatë procesit që ka ndodh ndërmjet  
19 ofensivave që janë lirue pa nga moskujdesia dhe janë arrestuar  
20 prapë. Por nuk më kujtohet detajet tash, si dhe kur.

21 PY. Nuk ju kujtohet se ku kanë qenë të mbajtur në kohën që ka  
22 ndodhur kjo gjë?

23 PË. Më shumë e mbaj mend prej procesit që kemi fol për këtë  
24 rast, sesa më kujtohet koha kur ka ndodh.

25 PY. A ju kujtohet se kush i kishte liruar?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04746 (Vijim) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdon)

Faqe 90

1 PË. Jo, znj. Prokurore, tash nuk më kujtohet. Por e di që  
2 është në proces gjyqësor dhe pajtoj me gjitha ato që kemi  
3 thënë. Janë të thonat e hershme, menjëherë pas luftës. Janë më  
4 të besueshme se tani.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni, do t'i  
6 lexoj një pjesë të shkurtër të deklaratës së mëparshme që  
7 trajton këtë çështje. Dhe referenca për palët është  
8 SPOE00119393 dhe faqja është 119396.

9 PY. Informacioni që keni dhënë aty ishte që, "Disa persona të  
10 ndaluar u sollën në Majac, meqë ishte bërë gabim në lirim e  
11 tyre u mbajtën përsëri pa urdhër tjetër. Nazif Mehmeti kishte  
12 kërkuar lirimin e tyre përpara se të liroheshin nga policia  
13 ushtarake".

14 Të ndihmon kjo?

15 PË. Unë nuk po më kujtohet, por unë ku e marr si të tillë.  
16 Pajtoj me të thënat e mia në atë kohë.

17 PY. Kemi marrë ndonjë në pyetje apo keni folur drejtpërdrejt  
18 me ndonjë prej të mbajturve?

19 PË. Po, kam fol me Fadil Sulejviqin.

20 PY. Kush e kishte autorizuar arrestimin e Fadil Sulejviqit?

21 PË. Unë.

22 PY. Përse u arrestua ai?

23 PË. Fadil Sulejviqi kishte provuar të ndërtonte njësi të  
24 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në regjionin ku unë kisha nën  
25 kontroll, ku unë isha përgjegjës. Dhe ne e dinim se Fadil

1 Sulejviqi ishte punëtor i Shërbimit Sekret Serb dhe ai po  
2 manipulonte me njerëzit në fshatrat e Prishtinës.

3 PY. Kur u arrestua ai, në çfarë kohe, domethënë?

4 PË. A në verën e 1998, nuk jam i sigurt me data, por ka  
5 evidenca. Ka qenë edhe vetë z. Sulejviqi dëshmitar në proces.

6 PY. Ku u ndalua, ku u mbajt ai?

7 PË. Në një fshat të Prishtinës. Është bo luftim mes njësiteve  
8 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe grupit të tij. Është  
9 marrë, domethënë, me forcë është arrestu dhe është sill në aty  
10 ku ishin njësitë e UÇK-së, të zonës operative të Llapit.

11 PY. Në çfarë shtëpie ndalimi u dërgua ai?

12 PË. Në Bajgorë.

13 PY. Ku ishte ai kur shkuat për ta marrë në pyetje?

14 PË. Në, as nuk e di apo ka qenë ambulante apo shtëpi private,  
15 ajo shtëpi ku ata, ku ai ka qendruar. Aty, në atë shtëpi kam  
16 shku. Aty ka fjet bashkë me ata njerëz që e ruanin, me  
17 policinë ushtarake, dhe ai ka fjet në të njëjtin vend.

18 PY. Pse vendosët që të flisnit me të?

19 PË. Kam shku me fol, më kanë interesue, më kanë bo përshtypje  
20 lidhjet e tij me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së.

21 PY. Çfarë të bëri ty të mendoje që ai kishte lidhje me  
22 Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së?

23 PË. E ka pranuar ai vetë. Dhe kanë pas ndërhyrje nga të  
24 deleguar nga Shtabi i Përgjithshëm për lirimin e tij.

25 PY. Kush, me kë konkretisht keni folur në Shtabin e

1 Përgjithshëm për rastin e Fadil Sulejviqit?

2 PË. Ka qenë dy-tre raste njerëzve që kanë ardhë fizikisht me  
3 të dërguar nga Shtabi i Përgjithshëm dhe kanë fol me mue, por  
4 unë vetëm sa shtoja bindjen që ai është me inteligjent, është  
5 me detyra nga shërbimi sekret serb. Fadilin e kemi njohur edhe  
6 më herët, ne eprorët e zonën së Llapit dhe e kemi ditur ka  
7 qenë nën përcjellje nën vëzhgimin tonë dhe e kemi ditur që  
8 është njeri i dëmshëm që po dëmtonte njësitet dhe Ushtrinë  
9 Çlirimtare të Kosovës.

10 PY. A ju kujtohet se kush ishin këta persona që erdhën nga  
11 Shtabi i Përgjithshëm për të folur me ju lidhur me këtë  
12 person?

13 PË. Kohë e gjatë, por në emër të Shtabit të Përgjithshëm kanë  
14 ardhë, kanë fol. Mirëpo, ne kemi refuzu atë ta lirojmë; kemi  
15 menduar që kanë rënë në lajthitje nga shërbimi sekret serb,  
16 dhe me njërin jo të duhur po vepronin për regjionin e  
17 Prishtinës.

18 PY. E bëra këtë pyetje edhe më herët, por do ta përsëris edhe  
19 një herë: A u kyç ndonjëherë në UÇK ky person?

20 PË. Po. Ai ka pretenduar se është kyçur sa ka qenë i  
21 kontrollum nga pjesëtarët që unë i kam ngarkue, sepse ka  
22 dashtë të thotë ashtu, por asnjëherë s'ka qenë pjesëtar i  
23 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të  
25 paraqitet një deklaratë e mëparshme e dëshmitarit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04746 (Vijim) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdon)

Faqe 93

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
2 çaktivizuar]

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Referenca për këtë është  
4 SPOE00119393 në faqen 119397.

5 PY. Ajo çfarë ju thoni në këtë dokument është që:

6 "Ndërkohë që Fadil Sulejviqi ose kur Fadil Sulejviqi vjen  
7 në Bajgorë njësitë që e kishte marrë atë kishte folur me të.  
8 Kështu që ne e konstatuam që ai ishte i lidhur me shtabin.  
9 Këtë informacion, ky informacion na u konfirmua edhe nga  
10 Shtabi i Përgjithshëm. Kështu që ai u bë ushtar i UÇK-së dhe u  
11 lirua".

12 A është e saktë kjo, z. Mustafa?

13 PË. Është gabim.

14 PY. Pra, informacioni që i ke dhënë më përpara gjykatës në  
15 2003 është informacion i gabuar, kështu?

16 PË. Është gabim.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se mund t'i  
18 tregohet versioni në shqip dëshmitarit, në qoftë se do të  
19 vazhdohet me pyetja të tjera lidhur me këtë.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I kam përfunduar pyetjet e mia  
21 lidhur me këtë çështje. Megjithatë, në qoftë se dëshiron  
22 dëshmitar që ta shikojë dokumentin mund ta bëjmë këtë gjë pa  
23 problem.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
25 çaktivizuar] Në qoftë se e keni të mundur, ju lutemi,

1 tregojeni këtë dokument.

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Referenca për këtë dokument është  
3 SPOE00119400 dhe flasim për faqen 405.

4 PY. E gjetët paragrafin për të cilin po flisnin në ekran, z.  
5 Mustafa?

6 PË. Është gjetur, por unë s'po e kuptoj ashtu si e kuptoni  
7 ju. Është liruar, me siguri është gabim administrativ tek ne,  
8 s'po e di. Nuk besoj që unë kam mujt me e thonë.

9 Sido që të jetë, unë në përgjithësi ju them se Fadil  
10 Sulejviqi asnjëherë s'ka qenë ushtar i UÇK-së, por ka qëndruar  
11 bashkë me ushtarët.

12 PY. Pra, e pranoni që kështu lexohet në transkript edhe  
13 besoni që ka pas, ka ndonjë gabim aty, kështu?

14 PË. Po e shoh që po lexohet që është liruar. Por nuk është  
15 liruar deri në fund lufte. Kur ka përfunduar lufta është mbet i  
16 lirë dhe ka vazhdu si çdo qytetar tjetër.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të  
18 kërkoja që të kalonim në seancë private shumë shkurtimisht, në  
19 mënyrë që të diskutoj për një të ndaluar konkret. Nuk besoj se  
20 do zgjasë shumë, rreth dy minuta.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
22 çaktivizuar] Le të kalojmë në seancë private.

23 [Seancë private]

24 [Seancë private teksti i fshirë]

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17 [Seancë e hapur]

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

19 jemi në seancë publike.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

21 PY. A jeni në dijeni të faktit që i ndaluar ka qenë edhe

22 Milovan Stankoviqi?

23 PË. Po.

24 PY. A e dini se ku mbahej i ndaluar ai?

25 PË. Ai ka qenë, person që ka punuar në sigurim publik serb

1 dhe ka rënë në pozita të ushtarëve të mi, i armatosun dhe  
2 është kap. Ka qenë me uniformë, me pushkë të gjatë dhe është  
3 ndeshtë me ushtarët e mi në pozicionet e Ushtrisë Çlirimtare ë  
4 Kosovës.

5 PY. Kur thoni që punonte për sigurinë serbe, sigurinë publike  
6 serbe, a e dini konkretisht se çfarë punë kishte ai aty?

7 PË. Ai, tek ne është paraqitur si pylltar, roje pylli, por ka  
8 qenë i armatosur dhe me letër identifikuese të sigurimit  
9 publik serbe. Sistemi atëherë ka qenë njerëzit e armatosur  
10 kanë ruajtur pyllin, sistemi serb.

11 PY. Personat që punonin për pyjet, ishin të armatosur?

12 PË. Sistemi serb i ka armatosur, por kuptohet i ka vu tek  
13 afër pozicioneve tona për t'i identifikuar caqet tona.

14 PY. Po, do të thuash me këtë?

15 PË. Po.

16 PY. A jeni në dijeni që e ndaluar ishte edhe një femër?

17 PË. Po.

18 PY. Kush jua ka thënë këtë gjë?

19 PË. Sistemi. Stafi im me siguri. Por më shumë jam i njohur  
20 gjatë procesit gjyqësor me këta emra.

21 PY. A të treguan ndonjë gjë konkrete të veçantë lidhur me të?

22 PË. Jo, nuk më kujtohet asgjë. Znj. Prokurore, ne ishim në  
23 luftë me armikun. Kjo çështje e ndalimit të aq pak njerëzve  
24 nuk ishte e rëndësishme aq sa tani po e bëjmë ne, për ne, për  
25 mua dhe për stafin.



1 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kërkoj që të tregohen disa  
2 fotografi në ekran. Ju kërkoj ndjesë se duhet t'ju kisha dhënë  
3 numrin e referencës. Libri i parë që dua që të paraqitet është  
4 libri i "Flet Komandant Remi", referenca për versionin në  
5 shqip të librit është SPOE00330195. Ndërsa referenca për  
6 dokumentin e përkthyer në anglisht është SPOE00053263. Të  
7 paraqesim faqen SPOE00330254 në versionin në shqip. Ndërsa në  
8 versionin në anglisht dokumenti mban numrin e referencës  
9 SPOE00053299.

10 PY. Fillojmë me fotografinë që kemi në ekran. Fotografia e  
11 parë. Ju lutem, a mund të na thoni se kush është në këtë  
12 fotografi, kush tregohet në këtë fotografi?

13 PË. Janë dy shoferët e mi.

14 PY. Ku është bërë kjo fotografi?

15 PË. Në zyrën e shtabit tim në Llapashticë.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Zbresim më poshtë në faqe dhe  
17 shohim fotografinë që është në fundin e poshtëm të faqes.

18 PY. A i njihni personat që kanë dalë në këtë fotografi?

19 PË. Më kujtohet se kanë qenë ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare  
20 të Kosovës.

21 PY. A e dini se ku është bërë kjo fotografi?

22 PË. Për, është edhe shënimi poshtë. Shtëpia shërbente për  
23 shtëpi, mensë në Llapashticë, po shkruan. Aty ku ushqeheshim  
24 unë dhe ushtarët e mi.

25 PY. A është i saktë ky përshkrimi i fotografisë?

1 PË. Po.

2 PY. Ju përmendët që përdornit ndërtesën e policisë ushtarake  
3 për si kuzhinë për të ngrënë, kjo është kjo ndërtesa?

4 PË. Kjo ndërtesë është.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të shikojmë një fotografi  
6 tjetër, në fund në të djathtë të faqes.

7 PY. A e njihni këtë ndërtesë, z. Mustafa?

8 PË. Po, znj. Prokurore. Edhe më parë folëm për këtë qendër si  
9 kazermë ku kanë stërvitur ushtarët tanë, kanë fjet.

10 PY. Ku gjendjet kjo, në cilin fshat?

11 PË. Bajgore.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër. Shohim  
13 fotografinë në krye të faqes, si fillim.

14 PY. A është kjo ndërtesa ku ishte vendosur, ku ishte vendosur  
15 zona operative e Llapit në Llapashticë?

16 PË. Tash nuk do të mund ta identifikojta, po shkruan se po dhe  
17 unë besoj që po.

18 PY. A ju kujtohet shkallët që duhet të ngjisje në mënyrë që  
19 të futeshe në ndërtesë?

20 PË. Po, po jam i sigurt se kështu është. Aty ku ka qenë vendi  
21 ku unë kam qëndruar.

22 PY. A e dini nëse shtëpia është rindërtuar që prej asaj kohe?

23 PË. Po, është ndërtuar, janë ndërtuar.

24 PY. A e keni parë shtëpinë pasi është rindërtuar?

25 PË. Shumë herë, po shumë herë.

1 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Përpara sa të kalojmë në një  
2 dokument tjetër, a mund të shohim shkurtimisht fotografinë në  
3 fund të kësaj faqeje?

4 PY. A e dini se cili është ky vend, z. Mustafa?

5 PË. Është lagje e Prishtinës, Kolovicë, pas hyrjes në  
6 kryeqytet, me çlirimin e kryeqytetit këtu është vendos shtabi  
7 im.

8 PY. Faleminderit.

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të paraqesim një tjetër  
10 dokument tani. Numri ERN është SPOE00120826.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal kjo  
12 është prova materiale P117.

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit. Po mundohesha që të  
14 gjeja numrin. Nëse mund të kalojmë tek faqja 120835.

15 PY. Aty tregohet një fotografi me ngjyra dhe një shtëpi që ka  
16 numrin 7. A ju kujtohet kjo ndërtesa, z. Mustafa, kjo shtëpia?

17 PË. Po. Kjo ishte shtëpia më herët e djegur nga forcat serbe.  
18 Shtabi ku unë kam qëndru.

19 PY. Në Llapashticë, kështu?

20 PË. Po, në Llapashticë.

21 PY. Pra, kjo është shtëpia e rindërtuar, [e pakuptueshme]  
22 shtëpisë së më përparshme, kështu? E shoh që pohoni me kokë,  
23 por ju lutem thojeni me zë në mënyrë që ta pasqyrojmë në  
24 procesverbal.

25 PË. Nuk jam i sigurt a është e bërë fotografia para lufte a

1 pas lufte. Nëse është pas lufte, domethënë, është rindërtuar  
2 dy herë. Tash duket shumë më bukur shtëpia.

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të kalojmë në faqen 120837. Të  
4 shohim fotografinë në fillim të faqes, si fillim. Ju kërkoj  
5 ndjesë, kalojmë një faqe më përpara.

6 PY. A e njihni këtë ndërtesë ose këtë vend, z. Mustafa?

7 PË. E kam pa gjatë procesit sa ishin kundër meje, por nuk më  
8 kujtohet. Tash po më kujtohet që m'u ka tregu edhe atëherë.  
9 Edhe më ndihmoi policia e UNMIK-ut në të me uniformë ta  
10 identifikoj, ta di se për ku është fjala.

11 PY. Si e kuptoni ju? Çfarë vendi është ky? Ku është bërë kjo  
12 fotografi?

13 PË. Kjo fotografi është bërë gjatë hetimit të vendit të  
14 ngjarjes kur është bërë mbajtja në Llapashticë. Unë kështu po  
15 e kuptoj.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të kalojmë në faqen 120832. Ju  
17 lutemi, shihni fotografinë me numrin 2.

18 PË. Po.

19 PY. A e njihni këtë shtëpinë? E keni parë më përpara?

20 PY. E kam pa kur është bërë hetimi në vend; shiqimi i  
21 vendngjarjes nga gjykata, ku po bëhej procesi kundër nesh.

22 PY. A e dini se në çfarë vendi gjendjet kjo shtëpia?

23 PË. Llapashticë duhet të jetë.

24 PY. Nëse unë them që është në Majac, a është e mundur që  
25 shtëpia të jetë në Majac?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04746 (Vijim) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdon)

Faqe 101

1 PË. Mund të besoj nëse e keni vizituar, nëse i ke pa  
2 evidencat mund të jetë. Nëse është e përcjellë me evidenca  
3 edhe është. S'kam pse me dyshue. Nuk po më thotë kujtesa ime  
4 që është atje apo atje e sigurt.

5 PY. E kuptoj, thjesht po ju pyes, domethënë, në qoftë se e  
6 dini, në qoftë se nuk e dini, mund ta thoni këtë gjë.

7 PË. Jo, nuk e di. Nuk e di.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të kalojmë në faqen tjetër  
9 120833.

10 PY. A e keni parë më përpara ndonjërin prej këtyre ndërtesave  
11 dhe a e dini se ku gjenden ato?

12 PË. Ka ndërtesa me tri kate, unë besoj se kam qëndru në këtë  
13 shtëpi. Kam mujt me qenë unë në këtë shtëpi.

14 PY. Ku mund të jetë?

15 PË. Mund të jetë në Majac. Unë po e nxjerr përfundimin edhe  
16 prej kontekstit të fotove. Po i shoh njerëzit kush janë  
17 përreth. E shoh avokatin tim dhe policia e UNMIK-ut.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Për momentin kemi mbaruar punë me  
19 këtë dokument. Faleminderit.

20 PY. Më herët përmendët vizitën e anëtarëve të Shtabit të  
21 Përgjithshëm në zonën e Llapit kur u caktuat zyrtarisht  
22 komandant. Ju kujtohet ndonjë vizitë tjetër e Shtabit të  
23 Përgjithshëm në zonën e Llapit në shtator apo tetor të '98?

24 PË. Nuk besoj që ka mujt me pas në shtator apo tetor. Ka qenë  
25 kohë ofensivash. Mirëpo, edhe një herë e di se kam pas vizitë

1 nga Shtabi i Përgjithshëm.

2 PY. Afërsisht, si ju kujtohet, në ç'kohë kanë ndodhur këto  
3 vizitat nga Shtabi i Përgjithshëm?

4 PË. Kemi zënë rob dikun 8 ushtarë serbë dhe e di që ka  
5 rastisë të jenë mysafirë tek unë.

6 PY. Anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm ishin miq tuajt në  
7 Llap në kohën e arrestimit të tetë ushtarëve serbë, këtë po  
8 thoni?

9 PË. Më duket se po, me sa mbaj mend.

10 PY. Pra, i bie të ketë qenë në 1999 apo jo?

11 PË. Nëse është kjo kohë i bie ashtu. Ose kam bërë ndonjë  
12 ngatërresë, veç e di që kanë qenë edhe një herë tjetër. Me të  
13 thënat e mia të mëhershme unë pajtoj, unë, domethënë, qëndroj  
14 pas atyre të thënave.

15 PY. Dhe ju kujtohet se cilët nga anëtarët e Shtabit të  
16 Përgjithshëm ishin në Llap në kohën e arrestimit të këtyre  
17 ushtarëve serb?

18 PË. Unë e di që gjithëherë, Bislir Zyrapi ka udhëheq vizitat,  
19 ka mund të jetë edhe ndonjë tjetër.

20 PY. Po Jakup Krasniqi, ka qenë i pranishëm, ju kujtohet?

21 PË. Ka mund të jetë, po. Me siguri janë përshkrimet publike  
22 për vizitat e Shtabit të Përgjithshëm, ka evidenca edhe në  
23 gjyq edhe në intervista të mia më herët.

24 PY. Anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm a ndërморën ndonjë  
25 veprim në përgjigje të këtij veprimi, të arrestimit të këtyre

1 ushtarëve serbë, qëndruam në zonën e Llapit?

2 PË. Aty ka pas ndërmjetësim ndërkombëtarë; e di që ka qenë z.

3 William Walker dhe të tjetër. Ka qenë i përfshirë edhe Adem

4 Demaçi, më duket, shefi për politikë në zyrën në Prishtinë.

5 PY. Të kthehemi tek '98.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dua t'ju tregoj një dokument.

7 Numri i referencë është SPOE00055678. Faqja është 55838.

8 Referenca në anglisht është SPOE00055799. Është versioni ET i

9 Rishikuar që beson tani është i disponueshëm; faqja konkrete  
10 është 55838. Të shkojmë te faqet, ju lutem.

11 Të nderuar Gjykatës, të mos harxhoj kohën e vyer, duhet  
12 që ta identifikojmë referencën.

13 PY. Pra, z. Mustafa, t'i kthehemi vizitës suaj në Shtabin e

14 Përgjithshëm. Të kalojmë tek periudha shtator 1998 - mars

15 1999. Në këtë periudhë ku e kishte bazën Shtabi i

16 Përgjithshëm?

17 PË. Në malet e Berishës.

18 PY. Në malet e Berishës kishte, ishin bazuar në një fshat

19 konkret e kishin bazën?

20 PË. Po, sigurisht. Ajo ka qenë në një fshat në një shtëpi.

21 Tash nuk po më kujtohet emri i saktë i atij i fshatit edhe pse  
22 kam vizituar dy-tre herë.

23 PY. Nëse do t'jua thoja unë emrin, Divjakë, a ju duket se

24 është ky?

25 PË. Po. Po, e saktë.

1 PY. Afërsisht, sa herë keni shkuar në malet e Berishës për  
2 t'u takuar me Shtabin në tetor-nëntor 1998?

3 PË. Ndoshta dy-tre herë.

4 PY. E keni fjalën dy-tre herë në tetor dhe 2-3 herë në nëntor  
5 apo gjithsej dy-tre herë?

6 PË. Jo, nga zona ku ka qëndru unë ka qenë e vështirë të  
7 shkohet tri herë në muaj; ka qenë larg dhe është dashtë me  
8 kalu vijat e zjarrit në tre-katër vende, kështu që s'kam pas  
9 mundësi aq shpesh. Por gjatë gjithë kohës, po mendoj për dy-  
10 tre muaj, dy-tre herë.

11 PY. I vazhduam takimet e rregullta me Shtabin e Përgjithshëm  
12 deri në mars të '99?

13 PË. Sa herë ka mund. Unë kam marrë pjesë në mbledhjet e  
14 Shtabit të Përgjithshëm; jam munduar të jem i saktë, i  
15 përpiktë.

16 PY. Kush i organizonte këto takime në Shtabin e Përgjithshëm?

17 PË. Ju kam thonë sa herë, këto kanë qenë të organizuara nga  
18 Shefi i Shtabit, Bislum Zyrapi. Shpeshherë në këto takime kam  
19 takuar Jakup Krasniqin, Ramë Bujën, Sali Veselin e më vonë  
20 gjatë kohës së Rambujesë edhe Hashim Thaçin e të tjerë.

21 PY. Kush ishin të tjerët?

22 PË. Po kanë qenë Rexhep Selimi, kanë qenë Kadri Veseli.

23 PY. Rexhep Selimi ishte i pranishëm në këtë kohë gjatë  
24 Rambujesë apo edhe në raste të tjera?

25 PË. Me Rexhep Selimin kam pas takime, më kujtohet se kam pas



1 takime edhe më herët, dy-tre takime. Kishte detyrën e vet.

2 PY. Po komandantë të tjerë të zonave, a ishin të pranishëm në  
3 këto takime?

4 PË. Ka mund mos të vijë dikush, por ka qenë takim me  
5 komandantët e zonave ku isha edhe unë. Ishim edhe ata të  
6 tjerët.

7 PY. Sa për procesverbal, a mund të na identifikoni se cilët  
8 ishin komandantët e zonave të tjera në atë kohë?

9 PË. Po. Rrahman Rama, Ahmet Isufi, Sylejman Selimi, Shukri  
10 Buja, Ramush Haradinaj. Regjionit të Prizrenit janë ndërrue  
11 shpesh, vetëm më kujtohet që ka qenë me nofkën Komandant  
12 "Drini".

13 PY. Dhe një herë tjetër, Rrahman Rama, komandant i cilës zonë  
14 ishte ai?

15 PË. I zonës së Shalës.

16 PY. Ahmet Isufi, po ai? Komandant i cilës zonë ishte?

17 PË. Karadakut, quhej. Këto ishin dy zona me të cilat unë  
18 bashkëpunoja më ngushtë, i kisha në kufi.

19 PY. Po Shukri Buja, i cilës zonë ishte?

20 PË. Në Nerodime.

21 PY. Ju e thatë se Komandant "Drini" ishte i zonës së  
22 Pashtrikut, por Ramush Haradinaj për cilën zonë ishte?

23 PË. I Dukagjinit.

24 PY. Dhe së fundmi, Sylejman Selimi?

25 PË. Drenicë. Drenicë.

1 PY. Çfarë diskutohej në këto takime?

2 PË. Kryesisht për luftime dhe mundësitë e reja zhvillimore,  
3 ta zhvillojmë në një stad më të mirë luftën e Ushtrisë  
4 Çlirimtare të Kosovës. Për mundësinë si të fitonim përkrahjen  
5 e njerëzve tanë, por edhe të ndërkombëtarëve dhe mirëmbajtjen  
6 e luftës në përgjithësi.

7 PY. A raporttonin edhe për ecurinë në zonat tuaja përkatëse?

8 PË. Po, kemi bërë raporte të shkurtra gojore.

9 PY. Ju e thatë, ndërkohë, se u lëshua një urdhër me shkrim në  
10 një lidhur me ndalimin e bashkëpunëtorëve. Gjatë këtyre  
11 takimeve a jepeshin edhe urdhra të tjera nga Shtabi i  
12 Përgjithshëm?

13 PË. Jo, nuk më kujtohet asnjëherë.

14 PY. Edhe në qoftë se s'ju kujtohet ndonjë urdhër konkret, në  
15 këtë moment, a ju kujtohet nëse përgjithësi, në këto takime,  
16 jepeshin urdhra?

17 PË. Jo, znj. Prokurore, s'ka pas urdhra në këto takime.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua t'i  
19 referohem një pjese të deklaratës së mëparshme, ju lutem.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
21 çaktivizuar].

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dhe është Pjesa 7, faqet 9 deri  
23 në 10. Mund të paraqesim në ekran, nëse është e nevojshme. Dhe  
24 referenca për versionin shqip është Pjesa 7, faqja 10.

25 PY. Dhe ju thoni aty që:

1 "Nuk e di, thashë që kemi qenë të gjithë aty dhe ju  
2 tregova se si morën urdhrat prej tyre, i merrnin urdhrat prej  
3 tyre. Në fund të takimit mund të ndodhte që ata të na jepnin  
4 dy apo tre urdhra në një zarf në fund të takimit, por nuk mbaj  
5 mend detaje të tjera lidhur me këtë. Ajo që ka rëndësi është  
6 se urdhra apo veprime administrative ishin të shtypura për  
7 secilin prej nesh".

8 Dhe ju e keni fjalën konkretisht për urdhrin, një urdhër  
9 që ka të bëjë me ndalimet. Dhe po thoni që jepeshin zarfe me  
10 dy apo tre urdhra në fund të takimit?

11 PË. Unë kam thënë se në formë rekomandimesh, urdhra  
12 administrativë apo sido që doni ju quani, por kemi marrë  
13 udhëzime. Ato mund të quhen edhe urdhra; i kemi pranuar. Ka  
14 ndodh shumë rrallë kur kemi marrë, por i kemi marrë [e  
15 pakuptueshme], por më specifikisht për urdhër ndalimi nuk më  
16 kujtohet, nuk më thotë gjë. E pajtoj, pajtoj me atë çka kam  
17 deklarue edhe para gjykatës, para Prokurorit në intervistë.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dua që të kalojmë tani tek Pjesa  
19 8, faqja 3. Në shqip, po ashtu, është Pjesa 8, faqja 3 dhe  
20 vazhdon në faqen 4.

21 Faleminderit.

22 PY. Para një momenti thatë që ndodhte shumë rrallë që të  
23 merrnit udhëzime apo detyra nga Shtabi i Përgjithshëm. Dua  
24 t'ju lexoj këtu ku thotë:

25 "Ne i renditim detyrat që kemi marrë nga Shtabi i

1 Përgjithshëm. Besoj se arkiva e UÇK-së i ka ato. Kishte shumë  
2 të tilla, z. Prokuror. Nuk mbaj mend sa ka marrë. Kemi marrë  
3 kaq shumë detyra sa nuk ishim të gatshëm t'i zbatonim të  
4 gjitha, se s'kishim infrastrukturën e duhur për ta bërë  
5 punën".

6 E shikoni këtë dhe pajtoheni me mua që ju në fakt keni  
7 marrë shumë detyra, aq shumë sa nuk i zbatonit dot?

8 PË. Kemi marrë letra, udhëzime, rekomandime nga Shtabi i  
9 Përgjithshëm, ashtu siç kam thënë, që ne nuk kemi mund me i  
10 krye këto detyra.

11 PY. Përveç takimeve me Shtabin e Përgjithshëm, a keni pas  
12 koordinime me zonat e tjera operative?

13 PË. Po, të natyrave për ndihmë në rast të luftimeve që janë  
14 zhvilluar të ashpra, kemi ndihmuar [e pakuptueshme] aty ku  
15 kemi mundur. Zona-zonën, njësia-njësinë.

16 PY. A mund të na jepni një shembull kur një zonë tjetër i ka  
17 dhënë ndihmë zonës operative të Llapit?

18 PË. Gjatë dhjetorit ka pas njësitate të zonës së Shalës edhe të  
19 Karadikut që kanë luftue krah ushtarëve të mi të zonës sime.  
20 Në Lllapashticë, në Dobratin, Majac dhe gjetiu.

21 PY. Pra, ushtarë nga zonat e tjera erdhën të luftonin me ju  
22 në zonën e Llapit, kështu?

23 PË. Po, në mënyrë të organizume, të organizuar, kanë ardhë  
24 dhe janë rreshtu në vijë të frontit. Kanë bo luftë.

25 PY. Dhe çfarë ndodhi në dhjetor të 1998-s që e bëri të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04746 (Vijim) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdon)

Faqe 109

1 nevojshme një gjë të tillë?

2 PË. Forcat armike kishin sulmuar pozicionet tona dhe ne u  
3 detyruam t'u përgjigjemi edhe ka qenë një luftë, një betejë e  
4 ashpër.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani jam në  
6 një moment që dua të ndryshoj temë, prandaj mund ta ndërpresim  
7 këtu punën.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
9 mbaruam për sot. Do të fillojmë përsëri nesër në orën 09.00.  
10 Nesër do të kemi vetëm dy seanca, të mëngjesit dhe një përpara  
11 drekës. Pra, deri në 13.00.

12 Zonjë, mund ta nxirrni dëshmitarin.

13 Ju faleminderit që ishit i pranishëm.

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë gjë  
16 tjetër?

17 Atëherë, sot mbaruam, deri nesër në mëngjes në orën  
18 09.00.

19 --- Seanca mbyllet në orën 15.57

20

21

22

23

24

25